# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5684
E enjte, 24 janar 2019
çmimi 0.40 €

## Rama ia delegon kompetencat e ministrit të Jashtëm Gent Cakajt

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AVNI KLINAKU FAQE 4-5



# Zgjidhja me Serbinë duhet të bëhet në vija etnike

- Presheva, Bujanoci dhe Medvegja domosdo do t'i bashkohen Kosovës, kurse Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku do t'i bashkohen Serbisë

Sekretari i Përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, ka thënë se ndarja në vija etnike është zgjidhja e vetme që duhet të bëhet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se Presheva, Bujanoci dhe Medvegja duhet t'i bashkohen Kosovës, kurse Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku t'i bashkohen Serbisë. Klinaku ka deklaruar se arritja e marrëveshjes Kosovë - Serbi është e pashmangshme, por mund të vonohet deri në vitin 2020. Kurse sa i përket taksës ndaj produkteve serbe, Klinaku ka thënë se ajo duhet të mbetet në fuqi mirëpo, sipas tij, nuk duhet të lidhet me çështjen e njohjes

## AKTUALE



TAKIMI I DY KOLOSËVE, SHPRESË PËR MITROVICËN, KOSOVËN, SHQIPËRINË, MBARË SHQIPTARINË E, SIDOMOS, PËR SERBINË! F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

RINIS LOBIMI PËR LIBERALIZIM TË VIZAVE F. 3

ISH-USHTARI I UÇK-SË, NAZIF MEHMETI, INTERVISTOHET PËR DY DITË RRESHT NGA SPECIALJA F. 7

## EKONOMI

LËVIZJA VETËVENDOSJE KUNDËRSHTON PRIVATIZIMIN E TELEKOMIT F. 8

ÇËSHTJA E 'TREPÇËS' TË PREMTEN PRITET TË MARRË EPILOG F. 8

## KULTURË

VËSHTRIM MBI SENTENCAT E IDRIZ GJILANIT PËR ATDHEUN, KOMBIN DHE LUFTËN F. 13

Dr. Fitim RIFATI

## SPORT

MUHAXHERI: KOSOVA MUND TË KUALIFIKOHET NË KAMPIONATIN BOTËROR F. 18



# Ahmeti, skeptik për marrëveshje të shpejtë me Serbinë

Bashkëkryesuesi i ekipit negociator për dialogun, Shpend Ahmeti, ka shprehur skepticizëm lidhur me mundësinë e arritjes së marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. Në një konferencë për medie ai ka deklaruar të mërkurën se këtë bindje e ka arritur duke marrë parasysh agresivitetin e politikës shtetërore serbe kundër Republikës së Kosovës. Ai ka bërë me dije se ekipi negociator platformën për bisedime me Serbinë do ta bëjë gati për ta dërguar në Kuvend para 30 janarit FAQE 3






## Ministri Ismaili: Këtë vit funksionalizohet Fondi i Sigurimeve Shëndetësore

FAQE 2

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pas pesë vjet e gjysmë në krye të këtij dikasteri, Ditmir Bushati ia ka dorëzuar të mërkurën kryeministrit Edi Rama detyrën e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme

# Rama ia delegon kompetencat e ministrit të Jashtëm Gent Cakajt

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë ceremonisë së marrjes së detyrës së punës së ministrit të Jashtëm ka treguar se kompetencat për këtë pozitë brenda dhe jashtë vendit do t'ia delegojë Gent Cakajt



"Epoka e re"

TIRANË, 23 JANAR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, një ditë pas betimit në postin e ministrit të Jashtëm, ia ka deleguar kompetencat për këtë pozitë zëvendësministrit të kësaj ministrie, Gent Cakajt. Rama e mori vetë drejtimin e Ministrisë së Jashtme, pasi presidenti Meta refuzoi kandidaturën e Gent Cakajt, që solli edhe një përplasje fjalësh mes tyre, arsye për të cilën kryeministri ka deklaruar se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.
Propozimi i Ramës për ministër për Punë të Jashtme dhe Evropë erdhi pasi presidenti Meta refuzoi ta dekretojë ministrin e emëruar Gent Cakaj në këtë pozitë. Presidenti nëpërmjet një letre drejtuar kryeministrit kishte thënë se "profili i Gent Cakajt, i propozuar për postin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative, shtetërore, në secilin element dhe në tërësi". Megjithatë, të mërkurën, në ceremoninë e marrjes së detyrës, kryeministri bëri me dije se ai nuk do ta drejtojë këtë ministri. "Është fjala më e shkurtër në jetën time. Unë në funksionin tim ministër i Jashtëm i delegoj z. Gent Cakaj drejtimin e kësaj ministrie dhe përfaqësimin në institucionet ndërkombëtare", u shpreh kryeministri.
Ministri i ri i deleguar, Gent Cakaj, në fjalën e tij pas marrjes përsipër të diplomacisë shqiptare, ka thënë se Shqipëria nuk do të ketë asnjë ndryshim strategjik në politikën e jashtme, duke shtuar se "Shqipëria sot është në kuotën e saj më të lartë të përfaqësimit politik". "Shqipëria qëndron më afër se kurrë hapjes së negociatave. Jemi në fazën e pakthyeshme për ta kurorëzuar kryesimin e OSBE-së për vitin që vjen. Do të vazhdojmë me energji të reja dhe qasje proaktive", ka deklaruar Cakaj.
Gjatë ceremonisë së organizuar me stafin diplomatik, Ditmir Bushati vuri në dukje arritjet disavjeçare në krye të këtij dikasteri si dhe falënderoi të gjithë ekipin e ministrisë për punën dhe bashkëpunimin e frytshëm ndër vite. "Edhe pse nuk do të jem më pjesë e punës së përditshme, ndihem me fat që do të jem pjesë e historisë së këtij institucioni", ka thënë Bushati në fjalën e tij përshëndetëse. "Që në ditën e parë të detyrës jam mbështetur në tri vlera: integritet, besim dhe respekt", u shpreh ai. "Ministria që po lë pas është shumë herë më e mirë dhe solide për t'u përballur me sfidat e kohës se ç'ishte pesë vjet e gjysmë më parë", ka deklaruar Bushati.
Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka folur pas delegimit të kompetencave të ministrit të Jashtëm nga kryeministri Edi Rama te Gent Cakaj. Ai ka thënë se presidenti nuk mund të ndërhyjë apo të komentojë organizimin e brendshëm të ekzekutivit. "Presidenti nuk ndërhyn dhe nuk komenton për aktet e organizimit të brendshëm të ekzekutivit apo të ministrive. Unë si president i Republikës respektoj Kushtetutën dhe i kam shumë të qarta kompetencat e mia se cilit institucion mund t'ia delegoj autoritetin kushtetues për t'i lidhur marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë", është shprehur Meta.
Shqipërisë, që është anëtare e NATO-s që nga viti 2009, i është dhënë statusi i kandidatit për BE në vitin 2014 dhe shpreson që negociatat për anëtarësim t'i fillojë këtë vit.
Edhe pse ka marrë rekomandim pozitiv për hapjen e negociatave, zyrtarë të BE-së janë shprehur se Shqipëria duhet të vazhdojë të punojë në pesë prioritetet, që përfshijnë: reformën në administratën publike, efikasitetin e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar dhe forcimin e mbështetjen e të drejtave të njeriut.

# Ismaili: Këtë vit funksionalizohet Fondi i Sigurimeve Shëndetësore



PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar të mërkurën Fondin e Sigurimit Shëndetësor. Në këtë vizitë Ismaili ka takuar drejtorin e Fondit, Fatmir Plakiqin dhe të gjithë punëtorët të cilët punojnë aty. Pas këtij takimi, ministri i Shëndetësisë ka thënë se fundi i këtij viti do ta gjejë Kosovën me funksionalizimin e plotë të Fondit. "Vitin e kaluar kam thënë se 2019-a do të jetë viti i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Në vizitën që pata sot në këtë institucion, unë i sigurova edhe një herë për mbështetjen time të plotë në punën e tyre. Së bashku me drejtorin e Fondit, Fatmir Plakiqin, këtë vit do të orientojmë të gjitha kapacitetet tona që fundi i vitit të na gjejë me funksionalizimin e plotë të Fondit", ka thënë Ismaili. Më tej, ai ka dhënë edhe një lajm të mirë, duke treguar se nga gjysma e këtij viti do të nisë edhe kompensimi i barnave jashtëspitalore. "Nga gjysma e dytë e këtij viti, për herë të parë në Kosovë, do ta fillojmë kompensimin e barnave jashtëspitalore, si hapin e parë konkret drejt qëllimit final: sigurimet shëndetësore", ka thënë ministri Ismaili.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ekipi negociator platformën për bisedime me Serbinë do ta bëjë gati para 30 janarit

# Ahmeti, skeptik për marrëveshje të shpejtë me Serbinë

**Bashkëkryesuesi i ekipit negociator për dialogun, Shpend Ahmeti, ka shprehur skepticizëm lidhur me mundësinë e arritjes së marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. Në një konferencë për medie ai ka deklaruar të mërkurën se këtë bindje e ka arritur duke marrë parasysh agresivitetin e politikës shtetërore serbe kundër Republikës së Kosovës. Ai ka bërë me dije se ekipi negociator platformën për bisedime me Serbinë do ta bëjë gati për ta dërguar në Kuvend para 30 janarit**




EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 JANAR - Bashkëkryesuesi i ekipit negociator të Kosovës për dialog, Shpend Ahmeti, nuk beson në një marrëveshje të shpejtë me Serbinë. Në një konferencë të mbajtur për medie të mërkurën, ai është shprehur më pesimist se presidenti i vendit për këtë çështje. Ahmeti ka deklaruar se Serbia pret edhe më shumë koncesione, ndërsa pala e Kosovës mendon se i ka dhënë të gjitha koncesionet e mundshme. "Ndoshta presidenti Thaçi është më optimist dhe ndoshta di diçka që ne nuk po dimë. Nga ajo që po shoh, edhe si qëndrim i palës së Kosovës, edhe gatishmërisë së shoqërisë sonë, edhe qëndrimit të subjekteve politike, ne mendojmë se kemi dhënë mjaftueshëm. Nëse Serbia pret se do të vazhdojmë me koncesione të tjera, besoj se gjasat janë shumë të vogla për një marrëveshje", ka thënë Ahmeti. Ai ka bërë me dije se gatishmëria e Kosovës për të biseduar me Serbinë nuk duhet të kuptohet në asnjë mënyrë si gatishmëri për të bërë kompromise. "Ne po themi se jemi gati të ulemi të flasim, por në asnjë mënyrë kjo të mos keqkuptohet si gatishmëri e jona për të bërë ndonjë kompromis të dhimbshëm për atë njohje nga Serbia", është shprehur Ahmeti.

Ai ka thënë se gjatë javës së ardhshme do ta dorëzojë në Kuvendin e Kosovës platformën për bisedime. "Ajo platformë është e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. E dyta është që ajo platformë e thotë dhe duhet ta thotë, dhe besoj se do ta marrë mbështetjen e Kuvendit, është se ky dialog nuk është dialog pa qëllim. Pra, ky dialog e ka një qëllim që ta përmbyllë procesin e njohjes së ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Nëse nuk ka njohje të shtetësisë nga ana Serbisë, atëherë për ne ky dialog nuk ka kuptim", ka thënë Ahmeti. Ai është shprehur i bindur se kjo platformë do të jetë e gatshme për miratim në Kuvend para 30 janarit. "Besoj se do të jemi në gjendje ta dorëzojmë Platformën në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë javëve në vijim. Kemi pritur përgjigje nga çdo institucion për të shikuar se a mund të ndikojnë në platformë", ka thënë Ahmeti.

Kryetari i PSD-së ka vlerësuar se dialogu me Serbinë është në fazën fillestare, duke shtuar se këtë e ka kuptuar nga përgjigjet që i ka marrë nga të gjitha burimet zyrtare të kontaktuara në Prishtinë dhe në Bruksel. Duke shpjeguar aktivitetin e deritashëm të ekipit negociator, ai ka thënë se gjatë kësaj kohe delegacioni ka qenë i fokusuar në mbledhjen e informacioneve dhe fakteve, lidhur me takimet e mëhershme në mes të palës së Kosovës dhe asaj serbe, përkatësisht midis presidentit Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq. Po ashtu, ai ka treguar se delegacioni shtetëror ka krijuar tashmë gjashtë komisione: komisionin për të zhdukurit, komisionin për pronat, komisionin për trashëgiminë kulturore, komisionin për të drejtat e minoriteteve, komisionin për krimet e luftës dhe komisionin për ekonomi. Në kuadër të delegacionit shtetëror është themeluar edhe grupi juridik, i cili përbëhet nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët do të kontribuojnë me ndihmë juridike gjatë procesit të dialogut.

Ahmeti i ka dhënë mbështetje Qeverisë së Kosovës që mos ta heqë taksën për produktet serbe dhe ato boshnjake. "Jemi të gatshëm ta ndihmojmë edhe kryeministrin për të marrë një vendim të duhur, por njëherë nuk janë kushtet për ta hequr këtë taksë", ka thënë Ahmeti. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, ka nisur në vitin 2011 në Bruksel. Mekanizmat ndërkombëtarë kanë shtuar së fundmi thirrjet për arritjen e një marrëveshjeje ligjërisht të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

# Rinis lobimi për liberalizim të vizave



PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Në takimin e nivelit të lartë për mekanizmin e rasteve track-record (të shënjestruara), ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka theksuar se BE-ja është e interesuar për t'u siguruar se progresi për rastet e shënjestruara po vazhdon. Në takim morën pjesë ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi, kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi. "Kosova i ka plotësuar kushtet për liberalizimin e vizave dhe nuk kemi kushte shtesë", ka potencuar ministrja Hoxha, duke shtuar se disa prej vendeve anëtare që janë më hezituese duan të shohin se puna dhe përparimi për sundimin e ligjit po vazhdon. Sipas saj, mekanizmi track-record apo rastet e shënjestruara nga vendet anëtare të BE-së po shihet si një ndër treguesit kyç të sundimit të ligjit andaj, sipas Hoxhës, puna në këtë drejtim po vazhdon. Ministrja, po ashtu, ka theksuar se dinamizimi i agjendës integruese nuk do të ndalet, duke cekur se në ditët në vijim do të rifillojë lobimi, takimet me ministrat e vendeve anëtare që të binden për votën e tyre në Këshillin e Ministrave.

Flet për "Epokën e re", Avni Klinaku

# Zgjidhja me Serbinë duhet



## - Presheva, Bujanoci dhe Medvegja domosdo do t'i bashkohen Kosovës, kurse Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku do t'i bashkohen Serbisë

Sekretari i Përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, ka thënë se ndarja në vija etnike është zgjidhja e vetme që duhet të bëhet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se Presheva, Bujanoci dhe Medvegja duhet t'i bashkohen Kosovës, kurse Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku t'i bashkohen Serbisë. Klinaku ka deklaruar se arritja e marrëveshjes Kosovë - Serbi është e pashmangshme, por mund të vonohet deri në vitin 2020. Kurse sa i përket taksës ndaj produkteve serbe, Klinaku ka thënë se ajo duhet të mbetet në fuqi mirëpo, sipas tij, nuk duhet të lidhet me çështjen e njohjes

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 JANAR - Sekretari i Përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, ka thënë të mërkurën se procesi i dialogut Kosovë - Serbi duhet të vazhdojë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se arritja e marrëveshjes finale ndërmjet dy vendeve është e pashmangshme. "Mund të vonohet për shkak të këtyre zhvillimeve të brendshme, por nuk ka rrugë tjetër për zgjidhjen e problemeve. Duke e parë krejt historinë në mes të shqiptarëve dhe serbëve, duke e parë edhe mosgatishmërinë e faktorit ndërkombëtar që të hyjë fuqishëm në këtë temë, marrëveshja mund të vonohet, por besoj se në vitin 2020 do të arrihet", është shprehur Klinaku, duke shtuar se zgjidhja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të bëhet në vija etnike. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Lugina e Preshevës do të bashkohet me Kosovën, kurse veriu me Serbinë. "Besoj se zgjidhja do të bëhet në vija etnike pasi që problemi është në vija etnike. Kështu që, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja domosdo do t'i bashkohen Kosovës, kurse Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku do t'i bashkohen Serbisë", ka deklaruar Klinaku. Ai ka folur edhe për taksën ndaj Serbisë, duke thënë se ajo duhet të mbetet në fuqi, mirëpo jo të ndërlidhet me çështjen e njohjes. Sipas Klinakut, taksa nuk duhet të bëhet pengesë për marrëveshjen finale dhe për raportet me ShBA-në.

**"Epoka e re":** *Z. Klinaku, si i komentoni zhvillimet e fundit në skenën politike?*

**Klinaku:** Kohët e fundit çdo zhvillim politik është i lidhur ngushtë me dialogun, respektivisht me zgjidhjen përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Vetë taksa nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe faktori ndërkombëtar lidhet me dialogun dhe marrëveshjen politike. Pra, jemi në një situatë kur çdo gjë po kondicionohet nga dialogu dhe marrëveshja e ardhshme.

**"Epoka e re":** *Qeveria po insiston që taksa të mbetet në fuqi, por partnerja kryesore, ShBA-ja, po sugjeron heqjen e saj. Duhet të pezullohet kjo taksë?*

**Klinaku:** Kur është vendosur taksa është dashur të merret parasysh fakti se do të ketë edhe presion. Që nga fillimi maturia është dashur të jetë në nivelin e duhur. Personalisht mendoj se ende taksa nuk duhet të hiqet, pra duhet të ndiqet një politikë

# të bëhet në vija etnike

'tërhiq e mos e këput'. Në asnjë mënyrë taksa nuk do të bëhet pengesë qoftë për marrëveshjen finale, qoftë për raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tash për tash mendoj se taksa nuk e cenon as njërën e as tjetrën, por vetëm sa i ndihmon.

**"Epoka e re":** *Në opinion është komentuar një qëndrim i Departamentit të Amerikan Shtetit, sipas të cilit, në rast se Kosova nuk e pezullon taksën, mund të vihet në pikëpyetje mbështetja amerikanë për ushtrinë. Mbetja e taksës në fuqi, nuk e rrezikon partneritetin me ShBA-në?*

**Klinaku:** Ende nuk rrezikon asgjë. Jo vetëm që taksa si formë e reciprocitetit duhet të mbetet në fuqi, por reciprociteti në përgjithësi duhet të shtrihet edhe në fusha të tjera. Kurse për atë dokumentin për të cilin po flisni, si duket nuk ka qenë i vërtetë, meqë aty është paralajmëruar edhe një afat kohor (21 janar) për vendosjen e masave të tilla, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Ka persona dhe struktura të ndryshme që e kanë paraparë një dokument të tillë, por në të vërtetë nuk ka ekzistuar. Tash për tash nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës kemi vetëm deklarata publike dhe një disponim që taksa të hiqet.

**"Epoka e re":** *Edhe sa mund t'i bëjë ballë Kosova presionit ndërkombëtar?*

**Klinaku:** Nuk po shoh akoma presion, por politika e Kosovës në raport me taksën, ShBA-në dhe me krejt faktorin ndërkombëtar duhet ta ndjekë politikën 'tërhiq e mos e këput'.

**"Epoka e re":** *Besoni se taksa mund ta arrijë efektin dhe nuk do të hiqet deri në arritjen e marrëveshjes përfundimtare e cila parasheh njohjen e Kosovës nga Serbia siç po pretendon kryeministri Haradinaj?*

**Klinaku:** Taksa nuk duhet të lidhet me njohjen. Edhe kur shtetet e njohin njëra-tjetrën dhe vendosin marrëdhënie bilaterale mund të vendosin masa të reciprocitetit nëse e pengojnë në çështje të ndryshme njëra-tjetrën. Kështu që taksa nuk duhet të lidhet me njohjen. Taksa nuk duhet t'i pengojë vetëm dy çështje: marrëveshjen finale Kosovë - Serbi dhe raportet me ShBA-në. Sa për të tjerat mund të qëndrojë në fuqi.

**"Epoka e re":** *Si mund të vazhdojë dialogu dhe të arrihet marrëveshja përderisa taksa mbetet në fuqi dhe Serbia nuk dëshiron vazhdim të procesit pa heqjen e saj?*

**Klinaku:** Dialogu i tillë i kushtëzuar nga Serbia nuk prodhon asnjë efekt pozitiv. Në qoftë se dialogu nuk është interes i saj dhe nuk e harron taksën, Serbia do të nxjerrë edhe probleme të tjera, për shembull, për çështjen e ushtrisë. Në qoftë se Serbia insiston në zhbërjen e ushtrisë së Kosovës për të vazhduar dialogu atëherë çfarë duhet të bëjmë? Prandaj presioni duhet t'i bëhet Serbisë, dialogu duhet të vazhdojë, marrëveshja duhet të arrihet dhe taksa nuk ka lidhje me këtë punë, veç e ndihmon.

**"Epoka e re":** *Çfarë prisni nga ky proces tani ku pjesë e tij është edhe ekipi negociator i kryesuar nga Limaj dhe Ahmeti?*

**Klinaku:** Është krijuar një tollovi shumë e madhe në procesin e dialogut. Kemi dy pole pothuajse të kundërta: polin e presidentit dhe polin qeveritar. Përderisa poli qeveritar parasheh mosndryshim të kufijve dhe vetëm pengesa në dialog, nga ana tjetër koncepti i presidentit që shkon në drejtim të ShBA-së parasheh ndryshimin e kufijve. Kështu që është shumë problem për t'i lidhur këto dy segmente në shtetin e Kosovës.

**"Epoka e re":** *Si mund të arrihet marrëveshja përfundimtare në emër të Kosovës kur brenda saj kemi këto dy qëndrime diametralisht të kundërta në mes të presidentit dhe kryeministrit që janë dy figurat kryesore në skenën politike aktualisht?*

**Klinaku:** Është e vështirë edhe nga aspekti i brendshëm edhe nga aspekti i jashtëm. Serbia ende nuk i ka shprehur në dialog apetitet e veta të plota, por mendoj se të gjithë do të vijnë në një gojë sepse nuk ka zgjidhje tjetër. Pra, do të pajtohen të gjithë me ndarjen në vija etnike sepse në fund të fundit edhe problemi është në vija etnike. Nuk mund ta zgjidhim problemin ndryshe veçse aty ku buron.

**"Epoka e re":** *Prisni që këtë vit të arrihet marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi dhe a besoni se pjesë e saj do të jetë edhe bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën?*

Klinaku: Arritja e marrëveshjes Kosovë - Serbi është e pashmangshme. Mund të vonohet për shkak të këtyre zhvillimeve të brendshme, por nuk ka rrugë tjetër për zgjidhjen e problemeve. Duke e parë krejt historinë në mes të shqiptarëve dhe serbëve, duke e parë edhe mosgatishmërinë e faktorit ndërkombëtar që të hyjë fuqishëm në këtë temë, marrëveshja mund të vonohet, por besoj se në vitin 2020 do të arrihet. Besoj se zgjidhja do të bëhet në vija etnike pasi problemi është në vija etnike. Kështu që, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja domosdo do t'i bashkohen Kosovës, kurse Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku do t'i bashkohen Serbisë.

**"Epoka e re":** *Z. Klinaku, çfarë mendimi keni për qeverisjen e deritanishme të koalicionit PAN dhe rolin e opozitës dhe, a prisni ndryshime?*

**Klinaku:** Nuk pres ndryshime të mëdha për shkak të zhvillimeve të jashtme, për shkak të dialogut dhe qëndrimeve të BE-së dhe të ShBA-së. Është një qeverisje me zhvillime shumë të çuditshme. Ka elemente shumë pozitive, por ka edhe elemente shumë negative. Për shembull, vendimi për taksën është veprim shumë pozitiv, kurse ngritja e pagës së kryeministrit dhe stafit të tij është vendim tepër negativ. Kurse sa i përket opozitës, si gjithmonë, ajo është e çorientuar dhe e çakorduar pa një strategji dhe pa një forcë për ndryshimin e gjërave.

**"Epoka e re":** *Greva në arsim dhe paralajmërimi i shërbyesve civile për grevë, a mund të sjellë krizë?*

**Klinaku:** Gjasat janë të mëdha për një shpërthim social dhe pikërisht atë shpërthim social po e sforcon vendimi i kryeministrit për rritjen e pagës.

# Lista Serbe kundërshton deklaratat e presidentit Thaçi për Mitrovicën

Prishtinë, 23 janar - Deklarata e presidentit Hashim Thaçi, se bashkimi i Mitrovicës është proces i pandalshëm, ka ngjallur reagimin e kryetarit të Listës Serbe, Goran Rakiq, i cili e ka quajtur këtë deklaratë si sulmin më të ri ndaj paqes në Kosovë. Rakiqi përmes një deklarate thotë se në emër të popullit serb e porositë Thaçin, se serbët kurrë nuk do ta lejojnë bashkimin e jugut dhe veriut të Mitrovicës pasi, siç thotë, ky do të ishte një "parakusht për pastrim etnik nga qyteti i vetëm në të cilin serbët i shpëtuan pastrimit etnik në vitin 1999".

Ai thotë se serbët janë gjithnjë e më të përkushtuar ndaj paqes, bashkëjetesës me të gjithë dhe se këtë e kanë dëshmuar duke ruajtur karakterin shumetnik të qytetit në të cilin bashkë me serbët jetojnë boshnjakët, shqiptarët, romët, goranët, turqit dhe egjiptianët. "Me punë dhe jo me fjalë kemi treguar se si duhet të respektohet diversiteti, por deklaratat që bëhen nga Thaçi po përpiqen ta trembin popullin serb në këtë rajon dhe të njëjtat i kundërshtojmë me neveri" thekson në deklaratë kreu i Listës Serbe, Goran Rakiq, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se bashkimi i qytetit të Mitrovicës është proces i pandalshëm. Ai të martën priti kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiti, i cili ia dorëzoi Thaçit një peticion me rreth 17 mijë nënshkrime të qytetarëve që kërkojnë bashkimin e qytetit të Mitrovicës.

Presidenti Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka thënë se për bashkimin e qytetit të Mitrovicës tani e kanë radhën të veprojnë institucionet: Qeveria, Kuvendi dhe Presidenca.



# ‘Drejtësia 2020’ do t’i japë fund tranzicionit në sistemin e drejtësisë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 JANAR - Përmbyllja e tranzicionit në sistemin e drejtësisë, avancimi i progresit dhe rikthimi i plotë i besimit të qytetarëve në shtetin ligjor ishin në fokus të diskutimit të agjendës së përbashkët "Drejtësia 2020", bordi i së cilës mbajti të mërkurën takimin e parë për këtë vit. Me këtë rast u shpreh përkushtimi për planifikimin dhe zbatimin e masave konkrete të agjendës "Drejtësia 2020", përfshirë implementimin me sukses të ligjeve të miratuara së fundmi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Bordi i Agjendës "Drejtësia 2020", i përbërë nga ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, si dhe me pjesëmarrjen e ambasadores së EULEX-it, Alexandra Papadopoulou, shefit të sektorit politik, ekonomik dhe për integrime evropiane në Zyrën e BE-së, Riccardo Serri, zëvendëses së Zyrës Politike dhe Ekonomike në Ambasadën e ShBA-së në Prishtinë, Alison Storsve, kanë përcaktuar prioritetet e tremujorit të parë të këtij viti.
Përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë në vend kanë shprehur përkushtimin e tyre të plotë ndaj fuqizimit të fushës së sundimit të ligjit në Kosovë, duke theksuar se agjenda e përbashkët "Drejtësia 2020" është e fokusuar në masa konkrete të planifikuara dhe me afate kohore të përcaktuara.
Ndërsa partnerët zhvillimorë kanë shprehur përkrahjen dhe mbështetjen e tyre të plotë me ekspertët dhe burime të tjera për këtë projekt, në mënyrë që kjo agjendë të ketë sukses. "Drejtësia 2020" është e fokusuar në masa konkrete që synojnë përmirësimin e shpejtë të menaxhimit dhe efikasitetit



brenda sistemit të drejtësisë, rrjedhimisht janë përcaktuar pesë tema për të cilat është arritur pajtimi që të punohet në mënyrë intensive në muajt vijues, e që janë diskutuar të mërkurën: reduktim i lëndëve të vjetra; themelim i mekanizmave për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të dy këshillave; themelim i Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës; rritje e numrit të noterëve në bazë të formulës 1 noter në 10 mijë banorë; si dhe konsolidim i mirëfilltë i ndërmjetësuesve si pjesë integrale e sistemit të drejtësisë.
Anëtarët e bordit të agjendës "Drejtësia 2020" do të takohen rregullisht për ta përcjellë përmbushjen e aktiviteteve për të cilat janë pajtuar, duke u angazhuar për materializimin e të gjitha masave që janë pjesë e këtij agjende.



# Sherifi thotë se Kosova u vetëmbrojt me vendosjen e taksës pas agresionit të Serbisë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 JANAR - Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, i shoqëruar nga deputetë të këtij subjekti, kanë zhvilluar të mërkurën një takim me shefen e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ku është diskutuar për çështjet politike në vend.
Sherifi ka thënë se Kosova ka përfunduar të gjitha kushtet për liberalizim të vizave dhe pret nga BE-ja që në pjesën e parë të këtij viti t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës lëvizjen e lirë.
Sa i përket dialogut, shefi i deputetëve të Nismës Socialdemokrate ka përsëritur qëndrimin e këtij subjekti se nuk pranohet temë diskutimi ndarja e territorit apo shkëmbimi i territoreve. "Ne nuk pranojmë që temë diskutimi të jetë ndarja e territorit apo shkëmbimi i territoreve. Me formimin e ekipit shtetëror për dialog me Serbinë, bashkëdrejtues i të cilit është kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, besojmë se do të ketë progres në këtë çështje", ka thënë Sherifi.
Lidhur me taksën e vendosur ndaj Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, Sherifi ka thënë se është një vetëmbrojtje ndaj veprimeve që ka bërë ndër vite Serbia ndaj Kosovës. "Taksa nuk duhet të largohet derisa pala serbe t'i ndryshojë veprimet që ka bërë deri tani ndaj Kosovës. Çdo popull ka të drejtë të mbrohet kur sulmohet. Ne po mbrohemi nga sulmet agresive që po bën Serbia ndaj Kosovës", është shprehur Sherifi.

## Në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë, Hoti do të raportojë për programin kombëtar të rinisë

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të mërkurën në takim Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, i cili në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë do të raportojë për rrjedhën e zbatimit të Programit Nacional për Rininë. "I premtova përkrahje të fuqishme për programin që është hartuar ekskluzivisht për të gjithë nxënësit dhe studentët e Republikës së Kosovës pa dallim. Këtë vit nxënësi do të jetë në fokus", ka thënë Haradinaj.



# Bahtiri: Mitrovica do të ribashkohet, ky është amaneti i heroit Isa Boletini

Në qytetin e Mitrovicës të mërkurën është mbajtur akademi përkujtimore me rastin e 103-vjetorit të rënies së heroit kombëtar Isa Boletini




EPOKA E RE Qendresa RAMA

MITROVICË, 23 JANAR - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të mërkurën në sallën e Qendrës së Kulturës "Rexhep Mitrovica", buzë lumit të Ibrit, është mbajtur akademi përkujtimore me rastin e 103-vjetorit të rënies së heroit kombëtar Isa Boletini. Duke folur para të pranishmëve, në mesin e të cilëve ishin edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ministri i Financave, Bedri Hamza, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës (OVL e UÇK-së), Hysni Gucati, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, pasi ka përshëndetur të pranishmit, ka thënë se Isa Boletini është një atdhetar që ka bashkuar trojet shqiptare dhe ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për pavarësinë e Shqipërisë dhe për lirinë e trojeve shqiptare. "Mitrovica, e cila shumë shpejt do të ribashkohet, është edhe amanet i heroit Isa Boletini, që ta ruajmë të tërën, të bashkuar dhe ta zhvillojmë e çojmë përpara. Isa Boletini dhe të gjithë atdhetarët tanë që morën pushkën në dorë për lirinë e popullit dhe të Shqipërisë e të Kosovës, meritojnë respektin e të gjithëve dhe besoj se këtë e kanë. Ne kemi qenë një popull i vogël, por vazhdimisht jemi shquar për trimëri të madhe dhe kemi qenë pjesë e të gjitha përpjekjeve për liri dhe pavarësi, duke u rezistuar për shekuj pushtuesve barbarë deri në çlirimin definitiv. Falë këtyre përpjekjeve dhe luftës së lavdishme të UÇK-së ne sot kemi edhe shtetin e lirë dhe sovran të Kosovës, të cilin vetëm si të bashkuar mund ta ruajmë dhe zhvillojmë. Këtë ua kemi borxh dëshmorëve të rënë për liri dhe pavarësi, të cilët me gjakun e tyre të derdhur na e bënë të mundur këtë që ne sot po e gëzojmë", ka thënë Bahtiri.



Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeparlamentari Kadri Veseli ka theksuar se sa herë vjen janari kujtohen rëniet dhe vdekjet e njerëzve të mëdhenj të kombit tonë: Skënderbeut e Ismail Qemalit, por edhe luftëtarët e vonshëm të lëvizjes sonë kombëtare që ranë po në janar: Vëllezërit Gërvalla, Kadri Zeka, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu e Edmond Hoxha. "Sot jemi bërë bashkë për të kujtuar dhe nderuar një personalitet të madh të Kosovës, i cili po ashtu ra në janar, heroin e Mitrovicës, heroin e Kosovës, heroin e gjithë kombit shqiptar, Isa Boletinin. Sot porosia jetësore e Isa Boletinit na flet qartë dhe drejt, më shumë se kurrë: nuk ka jetë të mirë për individin pavarësisht prej gjendjes së kombit. Ne mund të jemi mirë veç kur kombi dhe shteti i kanë punët mirë. Kjo është dashuria e vërtetë për atdheun", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Në emër të familjarëve të pranishmit i ka përshëndetur stërnipi i Isa Boletinit, Gazmend Boletini, i cili ka falënderuar institucionet lokale dhe ato qendrore për përkujdesjen e tyre për figurën e heroit Isa Boletini. Për figurën dhe kontributin e heroit Isa Boletini për çështjen kombëtare dhe pavarësinë e Shqipërisë, me kumtesa janë paraqitur Sabile Keçmezi-Basha nga Instituti i Historisë në Prishtinë, Xheladin Shala po ashtu nga Instituti Albanologjik në Prishtinë, Mustafë Haziri nga Qendra për Studim dhe Hulumtim në Mitrovicë si dhe Enis Kelmendi nga Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", Dega në Mitrovicë.

# Ish-ushtari i UÇK-së, Nazif Mehmeti, intervistohet për dy ditë rresht nga Specialja

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Krime të Luftës në Kosovë për dy ditë me radhë (të martën dhe të mërkurën) e kanë intervistuar në Prishtinë ish-pjesëtarin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën e Llapit, Nazif Mehmeti.

Avokati Tahir Rrecaj, i cili mbron Mehmetin në këtë proces, ka thënë se klienti i tij po intervistohet në cilësinë e të dyshuarit për kohën gjatë së cilës ka qenë në luftë.

Përveç Mehmetit, kjo Gjykatë në Hagë ka intervistuar edhe Rrustem Mustafën dhe Sami Lushtakun, kurse Sokol Dobruna, Sabahajdin Cena dhe disa të tjerë janë intervistuar në Prishtinë.

Gjykata Speciale është trupi i katërt me radhë që merret me hetimin e krimeve të supozuara të luftës së pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Paraprakisht me këtë çështje është marrë edhe Gjykata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Tribunali Ndërkombëtar i Hagës si dhe Gjykata e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit - EULEX.



# Telekomi i Kosovës dhe MPMS-ja thellojnë bashkëpunimin

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Telekomi i Kosovës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshje për vazhdimin e ofrimit të shërbimeve tëtelekomunikacionit. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) edhe një herë rikonfirmoi se Telekomi i Kosovës, Vala, është zgjedhja më e mirë për shërbime të telefonisë mobile, fikse dhe internetit. Përmbajtja kryesore e ofertës së Telekomit në këtë marrëveshje përfshin pako shumë atraktive, internet me shpejtësi të lartë dhe mbulim gjithandej territorit të vendit tonë. "MPMS nuk është i vetmi institucion që i është bashkuar Telekomit të Kosovës vitet e fundit pasi që numri i institucioneve shtetërore dhe bizneseve private që kanë bërë kalimin dhe kanë vazhduar bashkëpunimin është shumëfishuar, duke pasur parasysh se shërbimet e ofruara janë shumë cilësore, çmimet janë të leverdishme dhe ka një kujdes të shtuar për konsumatorët tanë", ka thënë Bedri Istrefi, u. d. i kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës.

Telekomi i Kosovës do t'i ofrojë MPMS-së shërbim të pandërprerë të telefonisë dhe internetit, duke i mundësuar personelit të kësaj



ministrie që lehtësisht ta realizojë komunikimin e tyre të përditshëm me shërbimet e Telekomit të Kosovës.

"Nënshkrimi i kësaj marrëveshje lehtëson tej mase komunikimin e personelit të ministrisë sonë gjatë realizimit të punëve dhe detyrave të tyre të përditshme, meqë Telekomi i Kosovës ofron shërbim shumë cilësore dhe të favorshme", ka thënë Izedin Bytyqi, sekretar i përgjithshëm i MPMS-së.

Telekomi i Kosovës "Vala" do ta vazhdojë përmbushjen e synimeve strategjike për t'i plotësuar nevojat e të gjithë konsumatorëve, institucioneve publike dhe atyre private për qasje sa më të lehtë në shërbimet e internetit të shpejtë, telefonisë mobile, fikse dhe IPTV-së.




# Lëvizja Vetëvendosje kundërshton privatizimin e Telekomit




PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procesit të privatizimit të Telekomit të Kosovës. Sipas një komunikate për medie të kësaj lëvizje, kryeministri Haradinaj në një akt të paprecedent ka autorizuar fillimin e këtij procesi. "Aktualisht është në fuqi rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës ku Qeverisë dhe kryeministrit i kërkohet të veprojë për të kundërtën. Pra, për zhbërjen e kontratës kriminale me Z-Mobile dhe përfshirjen e profesionistëve në rimëkëmbjen nga kriza e qëllimshme ku e kanë futur Telekomin. Në vend se të zbatonte pikë për pikë këtë rezolutë siç e kërkon ligji dhe Kushtetuta, kryeministri Haradinaj u përkul para krimit të organizuar që ka mbërthyer Telekomin, ndërmarrjen publike me aksionarë 100 për qind Qeverinë e Kosovës, sektorin strategjik dhe fitimprurës", është thënë në reagimin e LV-së. Sipas LV-së, privatizimin e Telekomit nuk duhet ta lejojnë as qytetarët dhe as punëtorët e kësaj ndërmarrje. "Një përpjekje për privatizimin e Telekomit dështoi para katër vjetëve pas denoncimit të pazareve me kompaninë 'Axos Gmh'. Tani pas mbylljes edhe të procesit të arbitrazhit me këtë kompani kryeministri Haradinaj verbër po ecën hapave të Qeverisë Thaçi II. Telekomi nuk duhet të privatizohet. Këtë nuk do ta lejojnë as qytetarët e Republikës së Kosovës, as punëtorët e Telekomit", është thënë në reagimin e Lëvizjes Vetëvendosje.

## Lekaj mban dëgjim publik me qytetarët e Junikut dhe të Deçanit për autostradën e Dukagjinit

JUNIK, 23 JANAR (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, në dëgjimet publike me qytetarët e Junikut dhe të Deçanit, ka dëgjuar komentet dhe idetë e qytetarëve për autostradën e Dukagjinit. Duke marrë parasysh rëndësinë që ky projekt do të ketë jo vetëm për këtë rajon, por për mbarë Kosovën, Lekaj ka garantuar se sugjerimet e tyre do të merren parasysh në versionin final. Ai ka shtuar se autostrada, përveçse shkurton rrugën mes qyteteve brenda vendit, lidhë edhe korridoret pan-evropiane.

Qytetarët e të dyja komunave janë njoftuar hollësisht me të gjitha të dhënat rreth autostradës së Dukagjinit dhe nuk kanë nguruar ta japin kontributin në debat. Kryetarët e komunave, Agron Kuçi i Junikut dhe Bashkim Ramosaj i Deçanit, u shprehën të kënaqur që më në fund komunave të tyre po u jepet rëndësia e munguar nga qeveritë e kaluara.



# Çështja e 'Trepçës' të premten pritet të marrë epilog

Bordi mbikëqyrës i ndërmarrjes "Trepça", i kryesuar nga Ardian Syla dhe kryetari i Sindikatës së kësaj ndërmarrje, Shyqiri Sadiku, janë pajtuar për draftstatutin e "Trepçës" i cili tani pritet të procedohet në Kuvendin e Kosovës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 JANAR - Bordi mbikëqyrës i ndërmarrjes "Trepça", i kryesuar nga Ardian Syla dhe kryetari i Sindikatës së kësaj ndërmarrje, Shyqiri Sadiku, janë pajtuar për draftstatutin e "Trepçës" në mbledhjen e së mërkurës, e cila është mbajtur në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Ndërkaq komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal ka kthyer prapa projektstatutin e "Trepçës" pas vërejtjeve që kanë dhënë deputetët e këtij komisioni në mbledhjen e së hënës.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se në mbledhjen e mbajtur të mërkurën të gjitha palët janë pajtuar për draftstatutin e "Trepçës". Sipas tij, shumë shpejt pritet t'i jepet epilog kësaj çështje. "Draftstatuti i 'Trepçës' të premten do të dorëzohet në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, mandej komisioni e trajton atë. Dhe, siç e dini, hyn në agjendë që të përfundojë në janar", ka deklaruar Lluka. Edhe kryesuesi i Bordit të "Trepçës", Ardian Syla, për gazetën "Epoka e re" ka thënë se janë pajtuar njëzëri me sindikatën dhe grupet punese që më në fund të procedohet draftstatuti i "Trepçës". Ai ka shprehur optimizëm se brenda janarit do të miratohet në Kuvend ky draftstatut. "Në draftstatut u pajtuam të përfshihen vendburimet, përveç zonave të interesit që ishin të përfshira edhe në mbledhjen e fundit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Në këtë mbledhje u pajtuam që në parim çdo gjë që kanë propozuar grupet punese që janë formuar me vendim të kryeministrit Haradinaj që inkorporohen në statut, përveç çështjeve sociale që ka hyrë një nen në statut që rregullohet me një ligj të veçantë, kurse edhe njësitë e tjera janë përfshirë ashtu siç ka rekomanduar grupi punues", ka thënë Syla.

Mospajtimet në mes të bordit dhe Sindikatës së "Trepçës" kanë ekzistuar që nga korriku i vitit të kaluar për shkak të kërkesës nga sindikata që çështjet sociale të përfshihen në draftstatut dhe insistimit të bordit se çështjet sociale duhet të zgjidhen me ligj të veçantë.





TREPÇA
Parku Industrial Mitrovicë,
Republika e Kosovës, Mitrovicë, 40000

01 134
1 23.01.19
PRISHTINË/A

MARRËVESHJE

Bordi Mbikëqyrës mbajti mbledhje me datë 23.01.2019 dhe pas një diskutimi të gjatë në prani të përfaqësueseve të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik shqyrtoj Draft Statutin e Trepça sh.a. nen për nen dhe në mënyrë unanime pajtohen që drafti i dorëzuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik me datë 23.01.2019 të procedohet për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe më pas në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Epoka e re

| Përfaqësuesi i Qeverisë | Përfaqësuesi i punëtorëve |
|---|---|
| Ardian Syla | Shyqyri Sadiku |
| Kryesues i Bordit Mbikëqyrës Trepça sh.a. | Drejtor në Bordin Mbikëqyrës Trepça sh.a. |

1

## Sadiku: Të ketë unitet për 'Trepçën'

Për arritjen e pajtimit për draftstatutin e "Trepçës" ka folur edhe kryetari i Sindikatës, Shyqyri Sadiku, i cili ka apeluar që të ketë unitet në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që kjo çështje të marrë epilog. "Jemi pajtuar që të gjitha kërkesat tona që kemi pasur të inkorporohen në draftstatut, përveç çështjeve sociale që pritet të zgjidhen me Ligj të veçantë dhe për të cilat brenda tre muajve na ka premtuar ministri Lluka se do të gjejnë zgjidhje. Shfrytëzoj rastin të bëj thirrje te deputetët e Kuvendit të Kosovës që të kenë unitet dhe ta kalojmë këtë çështje", u shpreh Sadiku.

# Kryeministri Haradinaj viziton 'Devolli Corporation'

PEJË, 23 JANAR (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, i shoqëruar nga këshilltarët ekonomikë, ishte të mërkurën për vizitë zyrtare në "Devolli Corporation". Gjatë takimit me pronarin e kompanisë, Shkëlqim Devolli, kryeministri Haradinaj ka shpalosur planin ekonomik të Qeverisë që drejton, duke theksuar se viti 2019 do të jetë vit i ekonomisë.

Pronari i "Devolli Corporation", Shkëlqim Devolli, ka shprehur mirënjohje dhe ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për përkrahjen dhe mbështetjen që po ua jep sipërmarrësve vendorë. Devolli ka prezantuar para kryeministrit projektet e realizuara nga kompania e tij gjatë vitit 2018 si dhe synimet për vitin 2019.



# Ngrihet aktakuzë për falsifikim parash në Pejë

PEJË, 23 JANAR (ER) - Prokuroria Themelore e Pejës, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër V. I. për veprën penale falsifikimi i parasë, nga neni 302, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas aktakuzës, i pandehuri V. I. më 17 nëntor 2018, rreth orës 20:35, në magjistralen Deçan - Gjakovë, me dije dhe qëllim ka vënë në qarkullim paranë e falsifikuar, në atë mënyrë që, pasi kishte marrë me vete 280 (dyqindetetëdhjetë) euro të falsifikuara, ndalon me veturën e tij në një pompë për të marrë derivate, e ku më pas punëtorit të pompës ia jep 20 (njëzet) euro, kinse për pagesë. Pasi të hollat e falsifikuara i vëren punëtori i pompës, i pandehuri me shpejtësi largohet me veturën nga vendi i ngjarje. Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka përmbushur elementet e veprës penale të përshkruar si më lart. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar Gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënojë sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë.






# Haradinaj nderon atdhetarin Haxhi Zeka në 120-vjetorin e Lidhjes së Pejës

PEJË, 23 JANAR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të mërkurën ka bërë nderime te shtatorja dhe kulla e atdhetarit Haxhi Zeka në shënim të 120-vjetorit të themelimit të Lidhjes së Pejës. Ai ka thënë se rruga jonë ishte e gjatë dhe e vështirë por, falë përpjekjeve të pararendësve tanë, sot jemi afër realizimit të plotë të idealit të tyre. Sipas Haradinajt, populli shqiptar është mik për mikun dhe di ta respektojë edhe armikun, por asnjëherë më nuk jep nga toka dhe e drejta e tij. "Besëlidhja, si nyjë unike kombëtare, pati jehonë të madhe në unifikimin dhe mbajti gjallë idenë e lirisë së shqiptarëve. Rruga jonë ishte e gjatë dhe e vështirë por, falë përpjekjeve të pararendësve tanë, sot jemi afër realizimit të plotë të idealit të tyre. Populli shqiptar është mik për mikun dhe di ta respektojë edhe armikun, por asnjëherë më nuk jep nga toka dhe e drejta e vet", ka thënë Haradinaj.

# Aksioni për Nëna dhe Fëmijë shënon 'Javën e vetëdijesimit të kancerit të qafës së mitrës'

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, së bashku me koalicionin K10, po shënojnë 'Javën e vetëdijesimit të kancerit të qafës së mitrës' e cila ka filluar nga data 21 janar dhe do të vazhdojë deri më 27 janar. Kjo javë po shënohet me anë të rrjeteve sociale duke publikuar infografika dhe fakte rreth shkaktarëve, simptomave dhe mënyrave të parandalimit të kancerit të qafës së mitrës. Gjithashtu, kjo javë po shënohet përmes kampanjës online për ngritje të fondeve për ofrimin e pap-testeve falas. Një nga programet e Aksionit për Nëna dhe Fëmijë është skriningu i kancerit të qafës së mitrës ku përmes këtij programi ANF ka filluar ofrimin e pap-testeve pa pagesë i cili po vazhdon me sukses edhe në vitin 2019 në Komunën e Prishtinës dhe të Prizrenit.

Programi i skriningut të kancerit të qafës së mitrës, përmes pap-testeve, fillimisht u lansua në vitin 2016 dhe deri më tani ka mundësuar realizmin e pap-testeve për gratë në grupmoshat e synuara në tri Qendra të Mjekësisë Familjare në Prishtinë. Në vitin 2018 programi u zgjerua edhe në Komunën e Prizrenit.

Qëllimi i skriningut për kancer të qafës së mitrës është zbulimi i hershëm i qelizave jonormale të qafës së mitrës, në fazat e hershme, kur mund të hiqen me lehtësi para se të zhvillohet kanceri.




# Prishtina dhe "Microsoft"-i do të bashkëpunojnë për përmirësimin e cilësisë së shërbimit

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, është takuar me menaxherin e "Microsoft"-it për Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Bosnje, Sokol Vladi, me të cilin ka diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në mes të kryeqytetit dhe "Microsoft"-it.

Digjitalizimi i proceseve të punës, menaxhimi i informatave të brendshme, zbatimi i teknologjive të reja të "Microsoft"-it ishin disa prej temave kryesore të këtij takimi. Ekzekutivi i kryeqytetit po angazhohet në vazhdimësi që ta ngrehë standardin e shërbimit nëpërmjet shfrytëzimit të hulumtimeve shkencore dhe përparimit teknologjik. Në këtë takim është theksuar se qytetarët e Prishtinës do të përfitojnë shumë nga zbatimi i teknologjive të reja në shërbimet që ofron administrata.



# Takim i dy kolosëve, shpresë për Mitrovicën, Kosovën, Shqipërinë, mbarë shqiptarinë e, sidomos, për Serbinë!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Titanët nga balta:** Dje ishte një ditë e jashtëzakonshme që do të shënohet në të gjithë kalendarët botërorë; pagan, julian, gregorian dhe shënstefanian. U takuan dy kolosë që, po t'i qesësh në kandarë, nuk ka kandar që i peshon për shkak të kontributit të jashtëzakonshëm, shumëdimensional, konfidencial dhe triumfal. U takuan dy burra që të njëjtë nuk mund t'i gjeni në Kosovë, Shqipëri, Euroazi dhe Tanzani, as nga pamja e sidomos nga përmbajtja.

Agim Bahtiri është njeriu më inteligjent, më i mençur, më i emancipuari intelektualisht dhe kombëtarisht, gjeni i fshehur nën rrënjë të tartufëve (lloji më i kushtueshëm i kërpudhave), erudit i papërsëritshëm, prandaj i kërkoi falje publike që më herët pata menduar krejt të kundërtën e asaj që po shkruaj sot. I kërkoj falje publike edhe Albin Kurtit dhe Behgjet Pacollit; të parit sepse pata dyshuar në Albinin kur thoshte se Agim Bahtiri është 100 për qind vetë Hasan Prishtina dhe doli të jetë pikërisht ashtu. Më fal Albin për shpërfilljen e profecisë tënde për Agim Bahtirin. Behgjet Pacollit nuk i kërkoj falje për asgjë, por për Agim Bahtirin, po t'i mos kërkoja falje, në planin e ndershmërisë do të bëhesha karikaturë mizerie. Begja, sigurisht duke i dituar kualitetet e Agim Bahtirit, më pati thënë se ky do të bëhet kryeministër i ardhshëm i Kosovës dhe, mbase, edhe president i Kosovës nëse Pacolli do të vendoste të mos merrej më me politikë e që për mua do të ishte e paimagjinueshme ta shoh Begjen jashtë politikës. Si i sinqertë që është, ekuivalent i vetëm për të do të ishte po ta trashëgonte postin e Naim Tërrnavës dhe Begjës ky post do t'i shkonte për mrekulli. Kërkoj shumë falje, tovarish Behgjet Pacolli, sinqerisht!

Kolosi numër dy i këtij takimi, i pari është Agim Hasan Prishtina, është presidenti ynë i madhërishëm, Shkëlqesia e Tij, Zotëri Hashime Thaçi. Nëse doni ta gjeni një personalitet ku në ADN-në janë integruar të gjitha virtytet më të larta njerëzore, kombëtare dhe morale, atëherë, ky, pa asnjë dyshim, është zotëri Hashim Thaçi, president i Kosovës. Presidenti ynë është i njohur për sinqeritetin e tij, mbajtjen e fjalës publike të dhënë, respektues të besës që as Kanuni i Lekës nuk e ka të përshkruar, skajshmërisht i ndershëm, moralisht i papërsëritshëm, sakrifikues biblik, erudit i pasionuar, guximtar i pamohueshëm, modest dhe asket si me qenë misionar i rendit të Gjergj Fishtës, i lexuar si Aristoteli, njohës më i mirë i matematikës dhe algjebrës se vet Pitagora biznesmen më i suksesshëm se vet Ali Baba dhe Xhef Bezosi i Amazonit, më elegant se Klaudia Kardinale, me shije të veshjes që ia kalon edhe vet Xhoko Armanit, më i mëshirshëm dhe më i drejtë se vet Robespjeri, më orator se Ciceroni dhe Dantoni, më poliglot se Zylfikar Haxhi Merxha, më katolik (në politikë) se Papa Françesku, më donzhuan se vet Don Zhugani, më humanist se vet Hugo Çavezi dhe shumë cilësime, që për momentin, për shkak të emocioneve të mëdha nuk po më kujtohen e që, sikur me rastin e Agimit pata menduar se krejtësisht të kundërta më këto që po i shkruaj sot! Lëri pallavrat Behxhet e na trego për takimin parahistorik që ndodhi dje në Mitrovicë midis dy kolosëve, jo të Rodosit por të Burojës dhe Patosit! Takimit midis dy dinozaurëve, jo fosile antike por fosile politike!

**Si shkoi takimi:** Pasi u ulën burrërisht, u besatuan se do të jetë vetëm një Mitrovicë, ajo e Agim Bahtirit kurse ajo e Goran Rakiqit, me korrigjim të kufijve i takon Vojvoda Aleksandër Vuçiqit. Se po e marrim Preshevën, Bujanocin dhe Medvegjën nuk ka asnjë dyshim, askush nuk beson për këtë përveç Nexhat Dacit dhe një këshilltari të presidentit që, Luginën e Preshevës e ka aq afër sa që e ka edhe Luginën e Silikonit ku Kardashianka ka fërkuar prapanicën dhe amortizatorët e parë sikur edhe disa yje dhe yllesha të estradës kosovare dhe mbarëshqiptare. Dhe disa politikanë nga Shqipëria dhe Kosova, të cilët, çfarëdo që bëjnë, nuk skuqen, me të drejtë shkaku se fytyrën origjinale e kanë zëvendësuar me Fytyrën e Silikonit!

Le të dali një birë nëna, shqiptar apo joshqiptar, burrë, burrneshë apo lëneshë e që të dyshojë se Agimi dhe Hashimi nuk do ta bashkojnë Mitrovicë, si hap i parë e pastaj do ta bashkojnë Milloshevën me Svetozarevën, si hap i dytë për ta bashkuar Kosovën me Shqipërinë pasi që Edi Rama ta ketë bashkuar Shqipërinë me Serbinë e që në planin ekonomik thuaja se e ka bërë.

Para se të shkojë në Forumin Ekonomik në Davos ku do të flitet për çështje të mëdha ekonomike botërore dhe ku, mungesa e Hashim Thaçit do të ishte me pasoja katastrofale për rendin ekonomik botërorë, sikur që në kohë të lashta shkonin për këshilla te Orakulli i Delfit, edhe Hashimi shkoi për këshilla te Tarantulla e Agimit dhe suksesin e ka të garantuar! Kur bëhen bashkë dy mendje të ndritura atëherë kombi mund dhe duhet të flejë rehat. Për veten time, pas këtij takimi nuk mbaj mend të kem fjetur më rehat dhe më ëmbël. Me këtë budallallëkun tim, e lodhja kokën (nuk e di se çfarë përmbajtje ka) me tema të mëdha botërore dhe me problemet e kombit, sikur të gjithë shqiptarët! Tash e kemi një krijesë, me dy koka, një shqiponjë dykrenare, njëra e Agimit, tjetra e Hashimit. Prandaj, Bac u kry, na u kajt nëna! Tash, në vend të këngës për Zhuj Selamin, Dedë Gjo Lulin dhe Selmanë Kadrinë po e këndoj këngën: "Moj Dudija jonë me limona o, a po e pranon korigjimin e kufijve a t'u kajt nona o ... "më mirë se vet Linda Morina, primadona shqiptare e këngëve të vjetra katundare dhe thesar i eposit për të gjitha figurat e shquara të kombit! Po e bëtë një pordhë, të pazëshme afër Goran Rakiqit në Mitrovicën e Veriut, pas pesë minutave pasi e ka marrë kabllogramin, Linda ta ka kushtuar një këngë, dhe, po i bëtë dy pordhë patriotike si Edi Rama në Beograd, Linda Morina ta ka kushtuar një potpuri këngësh. Më duket se Linda ka kënduar, edhe për Agimin, edhe për Hashimin për shkak të kontributit të tyre të fundit për bashkimin e Mitrovicës por se i ka diskriminuar shumë e që nuk e ka bërë më herët; për dy pordhë e ka bërë një këngë të vetme! Po ndryshon bota, po ndryshon edhe Linda, si pasojë e ngrohjes globale!

## Edhe një asamblist i opozitës i bashkohet PDK-së në Drenas



**Drenas, 23 janar (ER)** - Të mërkurën radhëve të Grupit Parlamentar të PDK-së në Asamblenë Komunale të Drenasit iu bashkua asamblisti Arigon Sinani, ish-asamblisti i Nismës. "Ky lajm është i mirë për unitetin në Drenas, për ligjet dhe projektet që na presin gjatë vitit 2019. Arigoni së bashku me deputetë të tjerë do të japë kontribut për mirëqenien e komunës tonë. Drenica dje ishte bastion i UÇK-së, sot dhe nesër mbetet i PDK-së", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci.

## Ministri britanik: Shtyrja e Brexitit thyen besimin e elektoratit

LONDËR, 23 JANAR - Shtyrja apo anulimi i Brexitit mund të rezultojë me thyerje "shkatërruese" të besimit për elektoratin dhe është propozim më i keq sesa mundësia e largimit të Britanisë nga Bashkimi Evropian pa marrëveshje, ka thënë ministri britanik i Tregtisë për Brexit, Liam Fox. Ai ka thënë për "BBC"-në se shtyrja përpara e idesë për zgjatje të procesit po bëhet me qëllim të ndalimit të Brexitit. Sipas tij, një hap i tillë do të përbënte "rezultatin më të keq".
Ministri britanik u ka thënë ligjvënësve se duhet të mendojnë për "pasojat politike" të shtyrjes së Brexitit dhe jo vetëm për "pasojat afatshkurtra ekonomike".
Ligjvënësit britanikë janë duke propozuar plane të ndryshme për Brexitin, duke përfshirë idenë e shtyrjes së datës së largimit nga BE-ja. Mirëpo kryeministrja britanike, Theresa May, ka thënë se "mënyra e duhur" për ta përjashtuar mundësinë e Brexitin pa pakt është përmes pranimit të planit të saj, të refuzuar tashmë. Sipas ligjit aktual, Mbretëria e Bashkuar duhet të largohet nga BE-ja më 29 mars, pavarësisht nëse do të arrihet ndonjë pakt.
Vendimi për Brexitin ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja në krahasim me 48 për qind që e kanë kundërshtuar atë në referendumin e mbajtur më 2016.




# Strategjia e inteligjencës amerikane, Rusia dhe Kina ndër kërcënimet kryesore

UASHINGTON, 23 JANAR - Përpjekjet e Rusisë për ta shtrirë ndikimin e saj dhe modernizimi i ushtrisë kineze janë ndër kërcënimet kryesore me të cilat ballafaqohen Shtetet e Bashkuara, thuhet në Strategjinë Kombëtare të Inteligjencës së Shteteve të Bashkuara.
Raporti, i cili publikohet çdo katër vjet, paralajmëron për kërcënimin e mundshëm nga aktivitetet bërthamore të Koresë Veriore, aftësitë kibernetike në rritje të kundërshtarëve të ShBA-së dhe paqëndrueshmërinë politike globale. Si një udhërrëfyes strategjik i 17 agjencive të inteligjencës amerikane, raporti paraqet direktivat strategjike për punëtorët e inteligjencës për katër vjetët e ardhshëm.




Në raport thuhet se Shtetet e Bashkuara "po përballen me një botë gjithnjë e më komplekse dhe të pasigurt në të cilën kërcënimet po bëhen më të ndryshme dhe më të ndërlidhura".
Drejtori i Inteligjencës Kombëtare, Dan Coats, ka thënë në një letër që shoqëronte raportin se agjencitë e zbulimit të ShBA-së duhet të përshtaten në mënyrë që t'i përgjigjen asaj që ai e quan mjedis "i turbullt dhe kompleks". "Ne përballemi me ndryshime të rëndësishme në mjedisin e brendshëm dhe global. Ne duhet të jemi të gatshëm për t'i përmbushur sfidat e shekullit 21 dhe për t'i njohur kërcënimet dhe mundësitë", ka thënë Coats. Ai ka thënë se komuniteti i zbulimit të ShBA-së duhet ta përmirësojë bashkëpunimin midis agjencive dhe të jetë më inovativ.
Gjithashtu, Coats ka shtuar se agjencitë duhet të bëjnë më shumë për ta rritur transparencën dhe besimin e publikut në punën e tyre. Raporti nuk i kategorizon kërcënimet. Por pjesa e parë e saj i kushtohet kërcënimit të paraqitur nga "kundërshtarët tradicionalë", të cilët përpiqen të përfitojnë nga dobësimi i rendit ndërkombëtar të Luftës së Dytë Botërore dhe tendencave gjithnjë e më izoluese në Perëndim. "Përpjekjet e Rusisë për ta rritur ndikimin dhe autoritetin e saj ka të ngjarë të vazhdojnë dhe mund të jenë në kundërshtim me qëllimet dhe prioritetet e ShBA-së në rajone të shumëfishta", thuhet në raporti. **(REL)**

# Presidenti Trump planifikon ta mbajë fjalimin vjetor në Kongres



UASHINGTON, 23 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, planifikon të lëvizë përpara me planin e vet për ta mbajtur fjalimin vjetor në Kongres mbi gjendjen e vendit më 29 janar pavarësisht prej presionit të demokratëve për ta shtyrë fjalimin për shkak të mbylljes së Qeverisë dhe hedhjes poshtë nga Gjykata Supreme të një propozimi të tij për emigrantët.
Propozimi që presidenti amerikan Trump bëri javën e kaluar për t'i ndryshuar politikat e migrimit, si kompromis për një marrëveshje për hapjen e Qeverisë dhe ndërtimin e murit, hasi në kundërshtimin e demokratëve që udhëheqin Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit.
Kryesuesi i Senatit amerikan, republikani Mitch McConnell, ka thënë se Senati do të votojë për planin e presidentit amerikan. Kryesuesja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi dhe udhëheqës të tjerë demokratë i kanë rekomanduar presidentit amerikan, Trump, ta shtyjë fjalimin tradicional për gjendjen e vendit.

## Papa Françesku: Frika ndaj migrantëve mund t'i çmendë njerëzit

Vatikan, 23 janar - Papa Françesku ka thënë të mërkurën se armiqësia ndaj migrantëve është duke u nxitur nga një frikë e paarsyeshme. Ai i ka bërë këto komente teksa ka arritur në Amerikën Qendrore, zonë nga e cila migrantët janë duke tentuar të hyjnë në Shtetet e Bashkuara, transmeton "Reuters".
Presidenti amerikan Donald Trump i ka kërkuar Kongresit të ShBA-së 5.7 miliardë dollarë për t'i ndihmuar për ndërtimin e murit me Meksikën, ashtu që të mbajë migrantët jashtë Shteteve të Bashkuara. Kjo kërkesë është refuzuar ashpër nga demokratët në ShBA, duke rezultuar me mbyllje të pjesshme të Qeverisë amerikane.
Një nga gazetarët që ka qenë duke udhëtuar me Papën në Panama është raportuar t'i ketë thënë atij se ka parë disa pengesa që synojnë t'i ndalojnë migrantët për të mos kaluar në territorin e SHBA-së. Papa i është përgjigjur duke thënë se "Frika na bën neve të çmendur".
Imigrimi pritet të jetë një nga temat kyçe të diskutimit në vizitën gjashtëditore të Papës në Panama. Kryepeshkopi 82-vjeçar pritet t'i vizitojë këtë vit edhe Emiratet e Bashkuara Arabe, Marokun, Bullgarinë, Maqedoninë dhe Rumaninë. Ai ka thënë se ka dëshiruar që ta vizitojë edhe Irakun, mirëpo është këshilluar që të mos e bëjë një gjë të tillë sepse është shumë rrezik.



# Vështrim mbi sentencat e Idriz Gjilanit për atdheun, kombin dhe luftën



**Dr. Fitim RIFATI**
*Instituti i Historisë, Prishtinë*

Sentencat janë mendime filozofike të shprehura në pak fjalë, që përmbajnë një të vërtetë jetësore në përmasa e aspekte të ndryshme. Në anale të historisë, historiografisë, folkloristikës, religjionit dhe kulturës shqiptare, veç tjerash, me lakonizmin e tij ka hyrë edhe Idriz Gjilani, personalitet i shquar dhe poliedrik shqiptar. Janë të shumëllojshme sentencat e tij, por spikasin ato mbi trinominë e mbijetesës së popullit shqiptar, si: atdheu, kombi dhe lufta, që u bënë të njohura para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, në kohën sa Idriz Gjilani ishte figurë qendroredhe lider popullor, ushtarak, fetar, arsimor e shpirtëror i shqiptarëve.

## I. ATDHEU

Idriz Gjilani tërë jetën e tij e kishte preokupim kryesor atdheun. Në konceptin e tij, nocioni i atdheut zbërthehet si segment universal i jetës në trungun etnogjeografik. Tërësia territoriale në të cilën struktura shoqërore, organizative, kulturore e arsimore frymon e funksionon shqip, sipas pikëpamjeve realiste të Idriz Gjilanit përbën atdheun. Ai ishte plotësisht i bindur se gjuha dhe religjioni i shërbejnë atdheut dhe bashkimit të tij. Në sentencën e njohur: "Kemi tri fe, por kemi vetëm një atdhe të përbashkët, një gjak vëllazëror, një gjuhë, një diell e një Zot-dhe - Detyrë mbi detyra kemi bashkimin dhe mbrojtjen e atdheut, të kufirit të Shqipërisë... përballë armikut shekullor", Idriz Gjilani shpreh një përkufizim metafizik. Së pari, e vë atdheun në rend të parë si vlerë autoktone dhe detyrë unike për shqiptarët. Së dyti, minon e shuan propagandën fetare dhe pretendimet për përçarjen e shqiptarëve mbi baza të saj. Në këtë kontekst, atdheu sendërtohet dhe merr vend superior e diakritik në sentencën: "Nuk ka fe pa atdhe". Prandaj, në këndvështrimin e Idriz Gjilanit, shqiptari nuk duhet t'i dorëzojë armët, por duhet të luftojë e të therorizohet për lirinë dhe mbrojtjene atdheut. Sipas tij, lufta e shqiptarëve është përpjekje, sakrificë dhe e drejtë historike, natyrore e shoqërore. "Humbë vetëm ai popull që nuk lufton për atdheun e vet", konstatonte ai në një maksimë tjetër kushtuar atdheut.

Idriz Gjilani njihte konfiguracionin e kufijve historikë, etnikë dhe politikë të Shqipërisë. Trashëgimia territoriale, e tkurrur në vargonjtë shekullorë, është komponentë themelore në ruajtjen e saj dhe pengimin e procesit të copëtimit të trojeve shqiptare. Sipas tij, të mbrosh kufijtë e Shqipërisë prej 74000km2 dhe të flijohesh për lirinë e tyre konsiderohet pavdekshmëri, ndërsa të mos punosh e të mos luftosh për bashkimin e Shqipërisë është tradhti. Për këtë arsye, vetëmohimi për Shqipërinë etnike niste nga shembulli personal i Idrizit: "Një qind vjet t'i kisha jetë, të gjitha kam për t'i kaluar kaçak, e kurrë nuk kam për t'u pajtuar me pushtuesin e Kosovës e copëtuesin e Shqipërisë". Përgjithnjë, sipas Idriz Gjilanit, rruga e vetme për lirinë e atdheut kalonte nëpër homogjenitetin, koherencën dhe unitetin e plotë midis shqiptarëve.

## I. KOMBI

Kombi si bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike, të formimit psikik dhe afirmimit kulturor, është kategori e njohur në mendimin intelektual të Idriz Gjilanit. Mirëpo, shkalla e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, në diskursin politik të kohës kur jetoi dhe veproi ai, kishte nivel të pamjaftueshëm për t'i rezistuar platformave shoviniste e asimiluese të pushtuesittë huaj. Idriz Gjilanin veçanërisht e shqetësoi në masë procesi i emigrimit të shqiptarëve drejt Turqisë e Shqipërisë ndërmjet dy luftërave botërore. Rrjedhimisht, vetëdija për përkatësinë kombëtare ishte thelbësore për shqiptarët e Kosovës. Turmave popullore që kishin marrë rrugën e emigrimit iu tërhiqte vërejtjen: "Ju nuk jeni as myslimanë e as shqiptarë! Kurrë nuk do të bëheni Turq! Ktheni kaparet (paradhëniet, F.R) e tokës dhe qëndroni me pushkë e sëpata në dorë!". Ai konsideronte se ndaj kombit ngarkohej me përgjegjësi historike secili shqiptar që braktiste varret e paraardhësve të tij.

Në vizionin për të ardhmen e Shqipërisë etnike, Idriz Gjilani theksonte: "...Bashkimi i Shqipërisë... është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm". Në funksion të këtij ideali irredentist aingarkoi me përgjegjësi edhe klerikët e prijësitreligjiozë, që liturgjitë dhe predikimet fetare t'i kryenin në gjuhën shqipe;në gjuhën amtaretë shqiptarëve. Mirëpo, dy faktorë relevantë që ai vuri në spikamë për të ardhmen e bashkimit kombëtar, kishin të bënin me divergjencat dhe konvergjencat që përcaktonin procesin e këtij akti. Së pari, sentenca në formë porosie: "Nëse nuk mund të ndihmosh, mos shkatërro atë që na e fali koha dhe puno që shtëpisë t'i vihet kulmi", i adresohej heshtjes sësabotatorëve dhe kundërshtarëve të bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Së dyti, duke llogaritur se kombi serb ishte armiku historik i kombit shqiptar, nënvizonte: "I vëllazëruar me shqiptarët, por kurrë me serbët".Në këtë kontekst, Idriz Gjilani aludonte në bashkëpunimin e elementëve komunistë shqiptarë si aleatë politikë e ushtarakë me komunistët serbo-sllavë, qëqe përcaktues i çështjessë bashkimit kombëtar. Mirëpo, për Idriz Gjilanin ideja e bashkimit kombëtar ka karakter doktrinar. Ajo "duhet të ruhet edhe me sakrifica mbinjerëzore, duke bërë theror veten,fëmijët, familjet dhe miqtë".

## I. LUFTA

Lufta e armatosur, si fenomen diakronik shoqëror dhe ushtarak, që zhvillohet ndërmjet forcave kundërshtare gjatë një vargu betejash, është aksiomëprofesionalisht e njohur për Idriz Gjilanin. Ai, ndeshjet e armatosura i përjetoisi i ri, ndërsa arti i luftës përgjithësonte përvojën e tij nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak. Lufta ishte rruga e vetme për liri. Idriz Gjilani e ndjeu peshën e detyrës së komandantit ushtarak të forcave vullnetare për të mbrojtur kufirin e Shqipërisë etnike nga depërtimi i forcave agresore armike. Për këtë arsye ishte i vetëdijshëm dhe u përgatit që detyrën ushtarake ta kryente me ndershmëri. Kësisoj, Idriz Gjilani profilizoi mënyrën dhe metodat e luftës, për të unifikuar dhe kompaktësuar radhët e vullnetarëve në frontin e kufirit.

Për të kishte rëndësi të madhe përsosmëria, vigjilenca, trimëria dhe guximi për të luftuar i vullnetarit të armatosur. Nuk dëshironte tradhtinë, neglizhencën, sabotimin, tërheqjen, plaçkën e dhunën ndaj armikut. Një ndër sentencat mbi luftën, që ngërthen burimin e mendimit të tij analitik, drejtuar e proklamuar shpesh ushtarëve, ishte: "U është e lejuar lufta atyre që sulmohen. Të rreptë në luftë, por të ndershëm e zemërbutë me robërit dhe familjet e armikut". Vetëmohimi ishte kulm i therorizimit. Në këtë kontekst, nën prizmin e tij, sentencat mbi luftën zbërthehen deri në imtësi. Vdekja ose rënia në altarin e trupit të atdheut ishte akti më i admirueshëm për Idriz Gjilanin. "Ai që vdes për atdhe është djalë i merituar, është i dashur i Perëndisë. Ai është dëshmor. Pa atdhe të lirë nuk ka as jetë, as familje, as fe, as liri dhe as parajsë", është një maksimë afirmative e Idrizit,pohuar shpesh në fronte të luftës e mjedise të shoqërisë shqiptare.

Ai përkufizoi edhe rangun e dëshmorit. Sipas tij "dëshmor bëhet vetëm ai që ka fatin të goditet nga ana e përparme, në ballë". Si drejtues i forcave vullnetare të armatosura, veçonte mobilizimin mendor e emocional të ushtarakëve, duke këmbëngulur që ushtria armike të mos lejohej të depërtonte në tokat shqiptare pa kaluar më parë mbi trupat e tyre. Për këtë arsye tërhiqte vërejtjen: "Asnjë minutë nuk guxojmë për t'i mbyllur sytë para fatkeqësive që na kërcënohen. Vigjilenca është kusht për fitore, kurse pakujdesia është hap në tradhti.". Ai nënvizonte se fitorja e luftës qëndron në disiplinën e përgjithshme, në ndershmërinë, në moralin shqiptar dhe në bindjen ushtarake të luftëtarëve ndaj hierarkisë së udhëheqësve të grupeve luftarake.

Për të, mbrojtja e popullit dhe e vatrës nga dhunues e pushtues, është detyrë e shenjtë. Specifikonte pozitat strategjike që befasonin forcat e armikut dhe nuk dëshironte gabime e as përsëritje të tyre. "Përsëritja e gabimeve ka përgjegjësi para historisë", u thoshte shpesh ushtarakëve. Në perceptimin e tij për luftën, rezultatet dhe konkluzionet e saj, pa dyshim, ndër sentencat dhe botëkuptimet më vizionare, veçohet: "...Gjaku ynë ka për të qenë argument për kërkesat tona historike dhe armë për luftën e bijve tanë, që u lindën në kohën e këtyre luftërave për Shqipërinë etnike".

Për sa më sipër, sentencat e Idriz Gjilanit në trinominë piramidale "atdhe-komb-luftë", janë mendime të avancuara, iluministe dhe vlera kombëtare, që i kanë shërbyer si frymëzim forcave liridashëse shqiptare për realizimin e aspiratave historike. Afishimi i tyre nëpër institucione arsimore, universitare, shkencore, politike, ushtarake, fetare e artistike, do të shërbente si fanar ndriçues mbi ndërgjegjen kolektive.

*(Kumtesë e prezantuar në Gjilan, më 19 janar 2019, në Tryezën Shkencore kushtuar 70-vjetorit të martirizimit të Mulla Idriz Gjilanit, organizuar nga Komuna e Gjilanit dhe Lidhja e Historianëve të Kosovës "AliHadri" dega në Gjilan, në kuadër të Manifestimit Mbarëkombëtar "Flaka e Janarit" 2019.)*



E jashtëzakonshme

# Noton 25 metra nën akull në liqenin më të thellë në botë



Një burrë në Rusi ka notuar 25 metra nën akull, në liqenin më të thellë në botë, Baikal, si pjesë e një tradite në vend. Ai u zhyt pothuajse i zhveshur nën akull dhe notoi në ujin e ftohtë derisa doli në sipërfaqe nëpërmjet një vrime të hapur në akull. Aleksandr Shumskas tha se ishte thjesht "e frikshme, por jo e vështirë".

FOTO E DITES



Punëtorët afganë lustrojnë enë metalike në një fabrikë alumini në Herat /AFP/

E rrallë

# Gjenden kimikate të rrezikshme në pelenat e fëmijëve



Agjencia kombëtare e shëndetësisë në Francë, Anses, ka njoftuar se ka gjetur kimikate në pelenat e foshnjave që tejkalojnë nivelet e sigurisë. Testet gjetën substanca të cilat janë potencialisht të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Anses ka njoftuar se testet në pelena ishin të parat që u realizuan nga një organizatë kombëtare e shëndetit dhe sigurisë në botë.

## BARSOLETA E DITËS



**Kthehet djali prej shkolle dhe e pyet i ati:**
**- A e përmirësove atë njësh në matematikë, bir?**
**- Jo baba, se është e shkruar me laps kimik.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

## "THE GRINCH" 3D,




I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

## "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

## "MORTAL ENGINES" 3D,




Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers




Në ora 22:00

## "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot nuk duhet të akumuloni energji negative që mund t'ju shtyjnë të merrni vendime te gabuara. Qëndroni indiferente me koleget.



**DEMI**
Do të irritoheni nga sjellja e një personi të caktuar sot. Edhe pse ka shumë situata që duhet të sqarohen nuk mund të vendosin të tjerët për punët tuaja.



**BINJAKËT**
Të impononi sjelljet tuaja tek të tjerët nuk është gjëja më e mirë që mund të bëni sot. Do të krijohen çarje të mëdha në komunikimin me partnerin.



GAFORRJA
Nëse sot do të vini në plan të parë familjen, asnjë nuk do t'ju vë faj por do të marrë si shembull sjelljen dhe përkushtimin tuaj.



**LUANI**
Pas fazave disi të zhurmshme të jetës suaj dhe të kaluara në rrëmujë të plotë, ka ardhur momenti të ktheheni me këmbë në tokë.



VIRGJERESHA
Po kërkoni një udhërrëfyes sot dhe doni t'i besoni çdo gjë që ka të bëjë me punën tuaj. Nuk do të gjeni personin e duhur por do ta kuptoni vonë këtë gjë.



PESHORJA
Nuk mund t'i kombinoni gjithmonë impenjimet e punës dhe ato personale. Shumë herë duhet të zgjidhni ato që kanë më tepër rëndësi për ju.



**AKREPI**
Sot duhet të kapni momentin për të thënë atë që po e mendoni prej kohesh. Nëse ky çast ikën nuk do t'ju jepet një mundësi e dytë.



**SHIGJETARI**
Të rifitoni besimin e një personi që kë humbur do të jetë qëllimi i ditës suaj sot. Do t'ju duhet shumë mund për të rivendosur marrëdhëniet.



**BRICJAPI**
Sot duhet të jeni të sigurt në vetvete dhe imune nga kritikat që mund t'ju vijnë nga ambiente të ndryshme.



**UJORI**
Lejoni që një person i caktuar t'ju tregojë mënyrën për të realizuar një projekt tuajin. Me vonë do të kuptoni se sa shumë interesohet për ju.



**PESHQIT**
Do t'ju duhet të kaloni shumë orë në ambientin e punës sot për të mbyllur ato gjëra që i keni lënë pezull deri në momentin që do të merrnit miratim.

# Gigi shpreson për një rikthim të lidhjes me Zayn



Gigi Hadid ende interesohet për Zayn Malik dhe ende ndjehet me shpresë për të rikthyer lidhjen e saj. 23-vjeçarja nuk është e gatshme të heqë dorë nga dashuria e saj. Ish 'zogjtë' e dashurisë kanë kaluar vitin e kaluar duke u ndarë dhe duke u kthyer së bashku, por veprimet e tyre në asnjë mënyrë nuk po e dobësojnë ndjenjat e tyre për njëri-tjetrin. Në fakt, dashuria e tyre po del të jetë shumë e fortë. "Gigi dhe Zayn kanë një dashuri shumë të madhe dhe asnjëri prej tyre nuk është i gatshëm ta largohet", ka deklaruar një burim i afërt me Gigin për "HollywoodLife".

# David dhe Victoria Beckham nuk janë ndarë




David Beckham dhe bashkëshortja e tij Victoria, dolën për një darkë. Ish-futbollisti 44-vjeçar dhe dizajnerja 44-vjeçare u panë duke dalë nga një hotel të martën në Nju Jork. Kohëve të fundit u raportua se çifti i ka ndarë rrugët pas një kohe të gjatë bashkë por gjithçka u vërtetua kur të dy u panë shumë të lumtur pranë njëri-tjetrit.



# Lexy Panterra thotë se s'kthehet më kurrë me Brooklyn Beckham

Lexy Panterra ka folur për marrëdhënien e saj me Brooklyn Beckham. 29-vjeçarja fillimisht u lidh me Brooklyn në maj të vitit 2018 dhe vazhdoj me të për disa muaj. Mirëpo Lexy thotë se nuk ka plane për t'u rikthyer me të më. "Nuk ka asnjë shans që ne të kthehemi ose të flasim. Ai u përpoq të arrinte tek unë, por e kam injoruar", ka deklaruar Lexy në Domenick 'Nati Show'.



# Rihanna do të nisë një projekt të ri me 'Louis Vuitton'

Rihanna duket se do ketë një bashkëpunim me markën e njohur 'Louis Vuitton'. Këngëtarja e famshme ka arritur edhe një sukses të madh në industrinë e modës. Sipas 'WWD', Rihanna është vendosur të ketë një markë të linjës luksoze. Që nga emërimi si ambasadore me detyrë specifike për promovimin e arsimit, turizmit dhe investimeve për Barbados, Rihanna do të bëhet gruaja e parë e zezë për të krijuar një markë luksoze me 'Loius Vuitton', markën më të madhe të modës në botë.



Autor: GAZMEND MORINA

MAJË MALI; PJESA MË E LARTË E NJË MALI
FUTBOLLISTI BENZEMA (R. MADRID)
DAULLE / REGJISORI AMERIKAN BURTON
KALIBËR I TYTËS SË ARMËS
REOMIR, ERBIUM
EPOKA E RE
ZANORE
ZOG ME TRUP TË MADH E ME PENDË TË ZEZA
QË ËSHTË KTHYER NË GJENDJE TË LËNGËT; E SHKRIRË
UDHËHEQËSI KUBANEZ .... KASTRO

LLOJ MOTOÇIKLETE JO SHUMË E MADHE
PORTIERI SPANJOLL KASILLAS / KAJDE

KOMANDANTI I NJË ANIJEJE
EMËR FEMRE ANGLEZE

RRËMUJË
"U" pas dy "R" / KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE ..... BAKER

KOD I TELEFONIT MOBIL
BASHKËT. / SHPEND I MADH UJI ME PENDË TË BARDHEME
KORIJE / LEAGUE INDUSTRIAL DEMOCRACY

ERMELINDA MEKSI
PJALM I BIMËVE / ORGAN DREJTUES POLITIK I NJË PARTIE
BASHKËT. / LUFTËTARI PËR TË DREJTAT E ZEZAKËVE LUTHER KING
LUMË I MADH NË SHBA ME UJËVARA TËRHEQËSE

EPOKA E RE
INDIANA, DALLASI
SHTET NË AFRIKË (pashq.) / I PRERË, I VENDOSUR
I QËNDRU-ESHËM NDAJ SËMUNDJEVE / I MALLKUAR NGA KISHA

PUT
LIBRI PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE / "L" në mes të dy "R"

EPOKA E RE
AKTORI AMERIKAN NË FOTO (shqip.)
DËSHTIM I LINDJES SË FËMIJËS
SHKOP I BILARDOS
ISMET MUNISHI
POLITIKAN I NJOHUR SHQIPTAR
AKTORI SHQIPTAR HYSKJA / ZANORE
AMERICAN ACADEMY RELIGION / ZANORE
ZANORE / OLIVER TUIST

SHTAGA
SHAKULLINË / EMËR YNI FEMRE
GRUP I VOGËL USHTARËSH / PAJTUESHM-ËRI (krah.)

PRESIDENTI AMERIKAN BARAK .....
TËRKUZË / QË VEPRON ME GJALLËRI
MODELJA FEJZULLAHU / EMËR MASHKULLI SPANJOLL

ZHANËR I MUZIKËS
BENDI MUZIKOR ANGLEZ "IRON ......" / RAST
GAZ I PANGJYRË DHE PA ERË / QË ËSHTË PËRTEJ MASE
RAVENA / QË SHKON KEQ, QË NUK SHKON MBARË

DY BASHKË-TINGËLLORE
QYTET I MADH NË IRAK / VEPRIMTARI .... ÇELA
HEROI GJERGJ .... ALIA / DUKAT
TONI ANDERSON / KAFSHË SHTËPIAKE (sh.shq.)

ZBAVITËS
E PAGJAK / ZARZAVATE
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO ..... (BENFICA)

SHKRONJA XIX
KËNGËTARI STAFAJ / E TMERROVA, E .......
PËR (huaj) / DY BASHKË-TINGËLLORE
ZANORE / ISTRES
GODINA MBI LUMË / BIMË E KUQE QË PËRDORET SI USHQIM

GATESË E JONA TRADICIONALE (pashq.)
VEZAKE / NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË
BANORI I KRYEQYTETIT TË ARABISË SAUDITE / AKTORJA ... RINA

EMËR MASHKULLI MYSLIMAN
KRYEQYTETI I KAZAKISTANIT
GUXIMTAR / BASHKËTING.
LUZMA E BLETËS; TUFA E BLETËS / BIXHOZI
MOLDE / BASHKËT.

INVA MULA
TV NË SHQIPËRI / HENDEK I GJERË PËR TË UJITUR
IGLI TARE / U ARRATISA
BASHKËTING. / LUMË NË SHQIPËRI
SHKRONJA XVIII / KURESHTJE
KAPËRDIJ / NGJITËSI I XHAMAVE

FUTBOLLISTI FRANCEZ FILIP ..... (MILAN)
KËNGËTARE E NJOHUR PERUANE / NË RREGULL (bised.)
BASHKËTING. / NJË PLANET

RRYMË AJRI QË LËVIZ NË DREJTIME TË NDRYSHME (shq.)
EMRI I PASHAIT TË JANINËS
KËNGËTARJA E VJETËR SHQIPTAR ANITA .... / "NONTERA"
PËRHAPJE E VALËVE / JANË (ang. orgj.)
FUTBOLLISTI AUSTRALIAN ... CAHILL (EVERTON)

KËNGË DJEPI
BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.) / ABEDIN REXHA

EPOKA E RE
TRISKA / BASHKËTING.
LLOJ PAPAGALLI / ZANORE
I MITUR; KALAMA / ZANORE

AKTORJA MUÇOLLI
LUMË I YNI (shq.)
DY BASHKË-TINGËLLORE

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: SKUTER, IKER, KAPITEN, OTA, ARAMARA, RRU, PIN, L, ZABEL, EM, POLEN, T, KENI, IMUN, IDOL, DITARI, DEMIR, AAR, A, MATINA, CIKLON, TOG, OBAMA, LITAR, ARITA, ROK, MAIDEN, ETAN, R, GR, TIKRIT, ELEZ, TA, ARTAKTIV, ANEMIKE, N, ARDIT, PRO, U, URA, FLI, OVALE, RIADASI, REFIK, TRIM, ROJ, M, IM, KLAN, IT, K, M, HA, MEKSES, IMA SUMAK, R, ERA, TAKE, EMETIM, NINA NANA, AMARETAT, TALON, ARARA, I RI, VALINA, ERENIKU, SM.

# I përjetshmi plaku i Vlorës dhe Shqipërisë



Lufta e madhe kombëtare, që u bë në shekuj nga atdhetarët shqiptarë, kulmimin e të cilës e pati në kryengritjet e viteve 1911 dhe 1912, u kurorëzua me shpalljen e pavarësisë në Vlorë, në 28 nëntor 1912. Njëri prej tyre, mbase më i madhi i kohës së tij, ishte Ismail Qemal Vlora. I njohur tashmë si Plaku i Shqipërisë, ai veproi, punoi pa rreshtur e luftoi në kushte shumë të rrezikshme për kombin, për shpëtimin e popullit nga skllavëria anadollake.

Dhe ja mbërriti. Sot, 100 vjet nga vdekja e këtij vigani, kujtojmë me nderim rolin e madh e të paharrueshëm që luajti në bashkimin e kombit e krijimin e shtetit shqiptar. Epoka në të cilën veproi Ismail Q.Vlora për realizimin e aspiratave kombëtare, nuk mund të kuptohet dot pa u njohur me mjedisin shoqëror e politik të kohës.

Shumica e historianëve tanë, studiues të kësaj periudhe, në nxjerrjen e përfundimeve përgjithësuese pothuaj janë në një mendje kur thonë se Ismail Qemali, me pak përjashtime, gëzonte urrejtjen e feudalëve të mëdhenj. Pashallarë e bejlerë, zotërues të çifligjeve, ndonëse shqiptarë në kombësi, por që sundimin feudal të Turqisë e kishin në zemër, shihnin më me interes atë, se sa një Shqipëri të pavarur.

Ajo, Shqipëria e pavarur, u hiqte atyre pushtetin e privilegjet dhe bënte të pasigurta pasurinë e sundimin. Në rrethanat historike, kur më 28 Nëntor 1912 u shpall pavarësia nga Turqia, Shqipëria e coptuar sundohej e qeverisej çiflig më çiflig nga "paria", pjesa dërmuese e të cilëve nuk e njihte pushtetin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe vetë kjo ishte e paaftë ta shtrinte autoritetin e saj ndër ato vise. Kështu, në fshatrat e qytetet e Myzeqesë sundonte Aziz Pashë Vrioni; në Orosh të Mirditës, Prenk Bib Doda; në Lezhë, Breg-Mat e Shëngjin, Dedë Coku e Vat Marashi; në Elbasan, Aqif pasha; Shkodra ishte nën pushtimin e një detashmenti të ushtrive ndërkombëtare, nën kryesinë e kolonelit anglez, Filips, por që mbikëqyreshin nga admirali britanik, Bërni; në Himarë qeveriste agjenti grek Spiro Milo; në Gjirokastrën e pushtuar, qeveria e Jorgji Zografos; në Mat e më tej, Xhelal e Ahmet Zogu dhe shumë mercenarë që vepronin përgjatë kufijve verilindorë, si Arif Hiqmeti, Jusuf Beu, etj. Dibrën e qeveriste Jusuf bej Dohoçishti; përtej Drinit, Arif Hiqmeti me 2000 shqiptarë të veshur e të armatosur me pushkë e me uniformë serbe, i shërbente qeverisë serbe. Por nuk mbyllej me kaq.

Këtyre u shtoheshin dhe udhëheqës të komuniteteve fetare, me qëndrim të dukshëm armiqësor ndaj pavarësisë, si Myftiu i Tiranës, Musa Qazimi; Dervish beu në Elbasan; në Korçë dhespoti grek, Germanos dhe në Durrës, dhespoti Jakov. Teki bej Rusi për llogari të Greqisë, së bashku me Feim bej Zavalanin, për llogari të Serbisë, ndërkohë mbërrinin pranë Ismail Qemalit si misionarë me propozime për "bashkime".

Dukej shkoqur se gjithë këta ishin kasnecë pararendës të fatkeqësisë kombëtare. Kudo mbizotëronte anarkia. "Unë jam turk, ç'lidhje kam me qeverinë e Ismail Qemalit?!", ishte përgjigjia e Esad pashë Toptanit, kur u pyet për qeverinë e përkohshme nga një gazetar i huaj, në maj të vitit 1913. Ky ishte qëndrimi i hapur e armiqësor i Esad Pashë Toptanit. Të ngjashëm me Esadin ishin shumica e pashallarëve me kombësi shqiptare. Me pasuri e toka, që e kishin vënë të parët e tyre, duke u shërbyer qenërisht okupatorëve turq, Shqipëria kish pak shpresa. Një idealist i shquar i kohës, Hil Mosi, më 20 gusht 1913, u bënte thirrje pasanikëve shqiptarë që të investonin kapitalet e tyre në atdhe. Si rrodhën ngjarjet më pas, asnjë nuk iu përgjigj thirrjes.

Atdhe ata kishin Turqinë, vendi që u kish dhënë pasurinë dhe privilegjet. Në kujtimet që sjell Sejfi Vllamasi, bën të njohur se Isamil Qemali nuk e lejoi dhe e pengoi Isa Boletinin, kur ai i shfaqi dëshirën që për interes të Shqipërisë ta zhdukte Esadin në ditët që ai erdhi në Vlorë, gabim që u korrigjua veçse pas shtatë vitesh veprimtari antishqiptare.

Plagët që i la në trup, Shqipëria i lëpiu për një kohë të gjatë. "…Shqipëria e helmuar dhe e përçarë nga armiqësia…", dolën si fjalë nga goja e Ismail Qemalit në fund të gushtit 1913, diktuar nga rrethanat dëshpëruese të krijuara nga sulmet tradhëtore, ndonëse më 29 korrik 1913, Konferenca e Londrës e kishte vendosur njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Në mbledhjen e 31 korrikut, ajo vendosi që në krye të shtetit shqiptar të caktohet një princ i huaj dhe, në vijim të traditës që kish filluar me Greqinë 90 vjet përpara, e pasuar nga Rumania dhe Bullgaria, ky princ s'mund të ish tjetër përpos se një gjerman. Ky vendim gëzoi shumicën e popullit. Pas kësaj, qeveritë lokale në Shqipëri u detyruan ta njohin Princ Widin si të vetmin sundimtar të Shqipërisë, ndërsa krahina e Dibrës kishte ngritur krye kundër sllavëve serbë.

Esad Pasha e ka rritur ndjeshëm sulmin e tij kundër Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Shpifjet e intrigat kanë zënë në kurth Myfit Libohovën, Azis Pashë Vrionin, Bektash bej Cakranin, Ahmet Zogun dhe, madje, me ta u bashkua edhe Faik Konica. Një varg i gjatë artikujsh të tij, fyes e tallës për "Malon", zinin faqet kryesore të gazetës "Dielli", të cilat ndikuan shumë për formimin e një opinioni dhe qëndrimi negativ te komuniteti shqiptar i emigrantëve të kolonisë së Amerikës, ndaj Ismail Qemalit.

Kështu, shqiptarët humbnin kohën e çmuar, duke u marrë me grindje të dëmshme. Më 1 shtator, 18 anëtarët e Senatit i dorëzuan Ismail Qemalit një dokument të nënshkruar prej tyre, ku përshkruheshin gabimet e kryetarit të qeverisë. "…Ne duam flamurin osman, prandaj do të ndahemi nga toskët", u thosh Esadi katundarëve të Shqipërisë së Mesme. S'vonoi dhe gabimin e Ismail Qemalit e bëri dhe Princ Widi.

Dy ministritë më të rëndësishme, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe atë të Luftës ia dha Esad Pashës. Shumë shpejt u dëshmua se nxitimi në vendimmarrjen e posteve që ju besuan Esatit, ishte një nga gabimet më të rënda të Widit. Të gjithë këta dhanë ndihmesën e tyre në stisjen e akuzës ndaj I. Qemalit në çështjen e komplotit të Beqir Grebenesë.

Fuqitë e Mëdha ia kishin pastruar rrugën Widit. Ismail Bej Qemali, kryetar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, u largua nga Shqipëria i detyruar prej Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Pikërisht njeriu mes shqiptarëve me më shumë përvojë politike dhe diplomatike; njeriu
që nuk i kish përkrahur kurrë xhonturqit; njeriu që asnjëherë nuk bëri propagandë për osmanlinjtë, siç bënte Esat pasha, u akuzua për intriga turkofile. Akuza, e ndërtuar me ndihmën e Syrja dhe Eqerem Vlorës, zgjodhi për përzënien e "plakut të urtë" Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, përmes dorës së kolonel Tomsonit.

Një pëlqim i I. Qemalit për një pjesëmarrje të qeverisë së tij për t'iu bashkangjitur organizimit të trupave vullnetare, siç iu tha në bisedë me Beqir Grebenenë, "…për luftën e tërësisë tokësore shqiptare, për tokat në Kosovë e Çamëri", u përdor për ta akuzuar si proturk?! Dhe kush? Ismail Qemali, për të cilin xhonturqit kishin dërguar dy herë me radhë njerëz për ta vrarë.

Ai u largua pas 14 muajsh qeverisje, me pushtetin e marrë nga Asambleja Kombëtare. Më 22 janar 1914 dha dorëheqjen, duke mbështetur ardhjen e Vidit dhe duke u bërë thirrje bashkëkombësve që t'i bindeshin autoritetit të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit.

Shqiptarët ja njohën meritën plakut të Vlorës, ia vlerësuan mënçurinë e ndërgjegjen e pastër, ia njohën aftësitë diplomatike dhe i janë mirënjohës për besnikërinë ndaj popullit e atdheut. Ai është e do jetë me emër dhe veprimtari i përjetshëm në historinë e kombit.

***(Bajram Peçi/Gazeta Shqip)***

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | |
|---|---|---|
| CHELSEA V TOTTENHAM | 3+ | |
| ESPANYOL - REAL BETIS | 3+ | |
| PETROJET - ISMAILY | 1 | |

# Muhaxheri: Kosova mund të kualifikohet në Kampionatin Botëror

Trajneri më i mirë në vend, Fatmir Muhaxhiri, ka thënë për "Epokën e re" se Kosova U20 mund të kualifikohet në Kampionatin Botëror, duke u bërë sporti i parë kolektiv që e arrin një sukses të tillë. "Me lojtarët që kemi dhe me përforcimet që jemi duke i kontaktuar me selektorin, e që një prej tyre është Albin Xhafollin, normalisht se do ta bëjmë një skuadër të fortë dhe do t'ia arrijmë qëllimit që të jemi përfaqësuesja e parë që do të kualifikohet në Kampionat Botëror nga sportet kolektive", ka thënë Muhaxheri



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 23 janar - Trajneri Fatmir Muhaxhiri është shpallur trajneri më i mirë i vitit 2018 nga Federata e Hendbollit të Kosovës. Trajneri Muhaxheri ka shkruar historinë e hendbollit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, ku me Përfaqësuesen U20 arriti ta fitojë garën me rëndësi të madhe IHF Trophy për Evropë dhe kështu ka hapur rrugën për të siguruar



pjesëmarrje historike në Kampionatin Botëror të Juniorëve që mbahet këtë vit. I kontaktuar të mërkurën nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", Fatmir Muhaxheri është shprehur shumë modest kur ka folur për çmimin e fituar, kurse meritor për këtë e ka bërë stafin e përfaqësueses, federatën dhe hendbollistët. "Çmimi 'Trajneri i Vitit' ka ardhur pas rezultateve që kemi pasur me Përfaqësuesen e Kosovës U20 dhe sukseseve që kemi arritur, por tash na pret një punë edhe më e vështirë për t'u kualifikuar në Kampionatin Botëror. Nuk jam i vetëm që i kam arritur këto sukses, por këtë e kemi bërë bashkë me Federatën e Hendbollit dhe shtabin teknik në krye me selektorin Taib Ramadani, Benon Braushi, Veton Hajrizi dhe mjekun Leonard Bushatin. Ky është stafi që i ka përcjellë këta djem që tre vjet dhe ky është një sukses i jashtëzakonshëm i gjithë hendbollistëve. Mosangazhimi i tyre apo mossuksesi do të ndikonte që të mos shpallem trajneri më i mirë, prandaj ata janë më meritoret", ka deklaruar Muhaxheri.

Trajneri pejan foli më pas edhe për cilësinë që e kanë shumica e hendbollistëve të rinj. Sipas tij, shumë prej tyre në një të ardhme të afërt mund ta bartin barrën kryesore edhe në Përfaqësuesen A. "Mund të themi se i kemi katër apo pesë hendbollistë që mund ta bartin barrën kryesore. Ne jemi bashkë që katër vjet dhe mund të them se kemi hendbollistë cilësorë si Tahirukajn, Muqollin, Luzhën, Gubetinin, Shabanin e të tjerë që për momentin nuk më kujtohen", ka shtuar ai. I pyetur se sa janë gjasat që Kosova të kualifikohet në Kampionatin Botëror, Muxhaeri është përgjigjur: "Me lojtarët që kemi dhe me përforcimet që jemi duke i kontaktuar me selektorin, e që një prej tyre është edhe Albin Xhafollin, normalisht se do ta bëjmë një skuadër të fortë dhe do t'ia arrijmë qëllimit që të jemi përfaqësuesja e parë që do të kualifikohet në Kampionat Botëror nga sportet kolektive".

Lidhur me cilësinë në hendbollin e Kosovës dhe me rezultatet në garat ndërkombëtare është shprehur i kënaqur trajneri Muhaxheri. Ai ka thënë se një tjetër e mirë në sportin e hendbollit është puna e madhe që po bëhet me gjeneratat e reja. "Mund të themi se cilësia e hendbollit është në ngritje, edhe pse në disa klube aty-këtu kanë rënie. Në katër skuadrat kryesore te meshkujt dhe femrat ka ngritje, por kushtet financiare kanë ndihmuar shpesh edhe te cilësia. Suksese kemi arritur si te përfaqësuesja, po ashtu edhe te ekipet që kanë marrë pjesë në garat ndërkombëtare, e të cilat kanë kaluar xhiron e parë, të dytën dhe të tretën dhe tash janë në mesin e gjashtëmbëdhjetë më të mirave siç ishte vitin e kaluar Shqiponja e në këtë vit Istogu. Besoj se skuadra e Istogut do ta japë maksimumin për të arritur rezultat pozitiv, por mos të harrojmë se po bëhet punë e madhe në gjeneratat e reja", ka pohuar Muhaxheri.

Nëse Kosova e fiton fazën interkontinentale me 20-vjeçarët, atëherë do ta sigurojë paraqitjen në Kampionatin Botëror të vitit të ardhshëm. Djelmoshat e Fatmir Muhaxherit në këtë fazë do të përballen me Nigerinë, Taipei Kinez, ShBA-në, Australinë dhe Paraguain.

### Komunat t'i përkrahin më shumë klubet sportive

Për të pasur sukses si në çdo sport ashtu edhe në hendboll duhet që klubet të kenë një stabilitet financiar, pasi shpenzimet janë të mëdha dhe shpeshherë të papërballueshme për klubet sportive. Lidhur me këtë trajneri Fatmir Muhaxheri, ka apeluar te drejtuesit e komunave që t'i japin prioritet hendbollit dhe sportit në përgjithësi. "Barra kryesore këtu bie te kuvendet komunale ku duhet të ndahen subvencione më të madha. Klubet i kanë shumat e kufizuara dy deri në tri mijë euro. Përveç skuadrës së Besës që ka kushte më të mira, deri-diku edhe Prishtina dhe Kastrioti, klubet e tjera si Trepça, Vushtrria, Gjakova kanë ekipe të mira, por kanë probleme financiare. Mendoj se kur të hyjë në fuqi edhe Ligji për sponsorime klubet do të kenë kushte më të mira për punë", ka deklaruar Muhaxheri, i cili ka porositur të punohet me përkushtim në mënyrë që rezultatet mos të mungojnë. "Sa më shumë të punojmë se kush do të jetë trajner. Hendbolli do të jetë shumë më përpara dhe të kemi ekipe cilësore që do të në prezantojnë në arenën ndërkombëtare.



## Kryeziu: Kualifikimi në Evropian, i arritshëm

Cyrih, 23 janar - Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Hekuran Kryeziu, në një intervistë të gjatë për gazetën e madhe zvicerane "Blick", ka folur edhe për shtetin që e përfaqëson. Mesfushori 25-vjeçar ka theksuar se ndihet shumë i lumtur në skuadrën "Dardane" me të cilën ndihet edhe i suksesshëm për shkak se Kosova para vetes i ka dy mundësi për kualifikim në "Euro 2020": përmes kualifikimeve dhe përmes "play-off"-it të Ligës së Kombeve, ku Kosova ka arritur njërin prej katër grupeve të Ligës D. "Kualifikimi në Evropian? Synim shumë i vështirë, por jo i paarritshëm", ka deklaruar Kryeziu. I pyetur për përzgjedhësin e Kosovës, zviceranin Bernard Challandes, Kryeziu është përgjigjur: "Është një trajner shumë i mirë prej të cilit mund të mësojmë shumë".



# Donjeta Sadikut i rezervohet një vend në Lojërat Evropiane 'Minsk 2019'



PRISHTINË, 23 JANAR - Boksieres Donjeta Sadiku i është rezervuar një vend për pjesëmarrje në Lojërat e Dyta Evropiane "Minsk 2019" që mbahen prej 21-30 qershor në Minsk të Bjellorusisë. Organizatori i ka konfirmuar Komitetit Olimpik të Kosovës pjesëmarrjen me ftesë boksieres Sadiku, e cila do të garojë në kategorinë deri në 60 kilogramë. Sadiku ishte bërë nënkampione e botës për juniore në vitin 2015 në Taipei të Tajlandës, ndërsa një vit më pas fitoi medaljen e artë në Kampionatin Evropian në Ordu të Turqisë, kategoria -57 kilogramë. Në dy vjetët e fundit Donjeta ishte e pafat, pasi iu mohua pjesëmarrja në Kampionatin Botëror për Juniore në vitin 2017 dhe vitin e kaluar në Botërorin e Senioreve. Të dy kampionatet u mbajtën në New Delhi të Indisë, shtet ky që ekipin e Kosovës nuk e pajisi me viza, shkaku i mosnjohjes së Republikës së Kosovës nga India. Krahas shpresës olimpike, me normë Kosovën në Minsk pritet ta përfaqësojë edhe një ekip i gjerë i xhudos, derisa pritet të marrin pjesë edhe garues të sporteve të tjera. Kujtojmë se Kosova është paraqitur edhe në Lojërat Evropiane "Baku 2015", në të cilat debutoi me medaljen e bronztë të fituar nga xhudistja Nora Gjakova.

# Toronto konfirmohet favorit për titull

TORONTO, 23 JANAR - Në NBA, kampionatin më të fortë në glob të basketbollit, u luajtën katër ndeshje të radhës. Referuar rezultateve, fitore ka marrë favoriti kryesor për ta rrëmbyer titullin e këtij sezoni, Toronto Raptors. Nisur edhe nga fakti se luante para mbështetësve të vet, në "Scotiabank Arena", kjo skuadër triumfoi kundër Sacramento Kingsit me rezultatin 120-105. Basketbollistët më produktivë te fituesit ishin Kyle Lowry dhe Fred VanVleet.




Secili prej tyre realizoi nga 19 pikë në parket. Marvin Bagley III ishte më i miri te "mbretërit", sepse regjistroi "double-double" falë 22 pikëve dhe 11 kërcimeve. Pas këtij suksesi të radhës, Toronto ka një bilanc pozitiv: 36 fitore dhe 13 humbje. Sacramento pësoi humbjen e 24-t, përkundrejt po aq fitoreve.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Oklahoma City - Portland | 123-114 |
| Dallas - LA Clippers | 106-98 |
| Phoenix - Minnesota | 91-118 |
| Toronto - Sacramento | 120-105 |

## SHKURT

### Llapi rrëmben talentin e Besës

Skuadra e Llapit nuk po ndalet në këtë afat kalimtar. Së fundi e transferoi edhe futbollistin Liridon Balaj nga Besa e Pejës. Futbollisti që ka lindur në vitin 1999 ka nënshkruar kontratë me Llapin për një vit e gjysmë. Balaj ka qenë pjesë e Kosovës U19 dhe tashmë është pjesë e U21-shave. "Drejtori ekzekutiv-sportiv Tahir Batatina që një vit është në bisedime për ta sjellë këtë talent te Llapi dhe këmbëngulësia e tij arriti që Liridoni të jetë pjesë e jona. Llapi falënderon edhe familjen për besimin që pati në drejtorin Batatina", thuhet në njoftimin e Llapit.

### Publikohet audio-mesazhi i fundit i Salas: Avioni po shkatërrohet. Kam frikë!

"Jam në avionin që duket sikur po shkatërrohet dhe po shkoj në Cardiff. Nëse brenda një ore e gjysmë nuk keni lajme nga unë, nuk e di nëse do të dërgojnë dikë që të më kërkojë, pasi nuk do të më gjejnë. Sa frikë që kam". Gazeta argjentinase "El Clarin", në faqen e vet të internetit ka publikuar mesazhin audio që futbollisti Emiliano Sala u ka dërguar në "Whatsapp" miqve të tij përpara se avioni me të cilin po udhëtonte të zhdukej nga radarët, pranë Britanisë së Madhe. Avioni po udhëtonte nga Nanta e Francës në Cardiff të Uellsit, pasi futbollisti kishte arritur marrëveshjen për të luajtur me klubin e Premierë Ligës. Sipas medieve angleze, piloti i avionit Piper PA-46 kishte arritur të ngrihej në fluturim vetëm në tentativën e katërt, duke qenë se tri përpjekjet e para nuk ishin të suksesshme për shkak të motit të keq.

### Bolti tërhiqet nga sporti

Pasi provoi të linte shenjë në futbollin profesionist, duke zhvilluar provime e teste në shumë skuadra të njohura, Usain Bolt vendos t'u japë lamtumirën të gjitha sporteve të preferuara. Njeriu më i shpejtë në botë për shumë vite, që shkroi historinë në pistat e vrapimit me tetë medalje të arta olimpike në sprint, iu dedikua për shumë muaj topit, por pa rezultate të kënaqshme. "Ishte e bukur për aq sa zgjati. U argëtova shumë që isha pjesë e ekipeve të ndryshme nga ato të atletikës. Nuk dua të them se nuk besova në futboll, por nuk e bëra në mënyrën e duhur. Tani jeta ime sportive ka mbaruar, e po drejtohem në fusha të tjera. Kam shumë projekte në mendje dhe fokusi im është biznesi", ka thënë xhamajkani Usain Bolt.
Usain Bolt u stërvit së fundmi me Central Coast Mariners, por nuk arriti t'i rrëmbente një kontratë skuadrës australiane. 32-vjeçari xhamajkan arriti të shënonte edhe gola në miqësore, por pretendimet për pagën dhe niveli mesatar i futbollit të luajtur e spostuan deri në largimin final.

### Roma dy javë pa Underin

Sulmuesi i AS Roma, Cengiz Under, është lënduar dhe do të qëndrojë jashtë fushave të lojës të paktën për dy javë. 21-vjeçari u dëmtua në fillim të pjesës së parë në ndeshjen ndaj Torinos. Analizat e para konfirmuan se turku duhet të qëndrojë pushim për dy javë, duke humbur ndeshjet me Atalantën, Milanin dhe Fiorentinën.

### Zapata mungon pesë javë

Në ndeshjen Genoa - Milan mbrojtësi Cristian Zapata është lënduar dhe pas trembëdhjetë minutave lojë është zëvendësuar. 32-vjeçari ka pësuar një tërheqje në kofshë, që do ta detyrojë të qëndrojë rreth një muaj jashtë fushave. Lojtari do t'u nënshtrohet ekzaminimeve pas dy javësh, por për dëmtime të këtij lloji koha mesatare e riaftësimit është pesë javë. Duke u rikthyer te sfida e "Marassi"-t, Cristian Zapata ishte aktivizuar duke shtrënguar dhëmbët, por në sforcon e parë bicepsi femoral i kolumbianit nuk e përballoi ngarkesën.

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada – Government*

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

## KONKURS

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve njofton se është hapur konkursi për aplikim të ekspertëve me marrëveshje për shërbimet e veçanta, për t'u bashkuar me panelet e ekspertëve që ndërmarrin veprimtari për verifikimin e standardeve të profesionit si dhe nw procesin e validimit tw kualifikimeve dhe akreditimit tw Instituconeve tw Arsimit dhe Aftesimit Profesional për:

- **Shtruesit e dyshemeve dhe punëtoret për vendosjen e pllakave me kod 7122.**
- **Teknikët e inxhinierisë elektrike, me kodin 3113**
- **Mekaniket e montuesit elektrike, me kodin 7412**
- **Instaluesit e ngrohjes qendrore, me kodin 7126**
- **Hidrauliket dhe montuesit e tubave, me kodin 7126**
- **Vlerësues i pronave te paluajtshme, me kodin 3315**
- **Ekspert për siguri në punë me kod 2150**

**Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:**

- Të kenë kualifikim përkatës të arsimit të lartë;
- Të jenë të kualifikuar dhe të kenë përvojë profesionale së paku 10 vite në fushën përkatëse;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në arsim, menaxhim apo të ngjashme;
- Të kenë përfunduar trajnime për vlerësim, zhvillim të kurrikulit, zhvillim të programeve;
- Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë konfidenciale me AKK,
- Shqyrtojnë aplikacionet dhe gjithë dokumentacion e ofruesve të AAP për akreditim të institucioneve,
- Realizojnë vizita në terren,
- Bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të panelit, diskutojnë dhe harmonizojnë qëndrimet e tyre,
- Kontribuojnë në përgatitjen e një raporti që përcakton të gjeturat (gjetjet) dhe rekomandimet në lidhje me akreditimin e institucioneve,
- I raportojnë Drejtorit të AKK.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kushtet, ti paraqesin dokumentet si në vijim:

- CV në formatin europass;
- Diplomat dhe certifikatat;
- Referencat.

Dokumentet që nuk I plotësojnë kushtet dhe kriteret e lartëcekura nuk do të shqyrtohen.
Aplikimi bëhet vetëm në formë elektronike tek **donjeta.nimani@rks-gov.net.**
**Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve,**
**Rr. Agim Ramadani p.n, Qendra e Studentëve , Prishtinë.**
**Tel: 038- 212 595**
**Afati i aplikimit: Nga data 23.01.2019 do 01.02.2019.**
**Për më shumë klikoni: www.akkks.rks-gov.net**

---

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
**Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality**

**DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM**

**Nr.13/51**
**Më: 23/01/2019**
**D r a g a s h**

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

**KONKURS**- plotësues

Për plotësimin e vendit të lirë të punës për arsimin fillor të mesëm të ulët të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2018/2019.

**SHFMU "Sezai Surroi" Bellobrad**

1. Një mësimdhënës për mësim klasor – Bellobrad (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)
2. Një mësimdhënës të gjuhës angleze -Brrut, Zym,Kapre (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

**SHFMU "Svetlost" Krushevë**

1. Një mësimdhënës për mësim klasor – Zlibotok (Boshnjakisht)

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj, Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.
**Vërejtje**: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 23.01.2019
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj

---

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada – Government*

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

## KONKURS

Nacionalni autoritet za kvalifikacije objavljuje da je otvoren konkurs za prijavu eksperata za Ugovor o posebnim uslugama da se pridruže panelima eksperata koji preduzimaju aktivnosti za verifikaciju standarda profesije, kao i proces validacije kvalifikacija i akreditacije institucija Profesionalnog obrazovanja i osposobljavanja iz:

- **Majstor podova i radnici za postavljanje pločica sa šifrom 7122.**
- **Elektrotehnički tehničari, sa kodom 3113**
- **Mehaničar elektro monter, sa kodom 7412**
- **Instalater centralnog grejanja, sa kodom 7126**
- **Hidrauličar i monter cevi, sa kodom 7126**
- **Ocenitelj nekretnina, šifra 3315**
- **Stručnjak za bezbednost na radu sa Kodom 2150**
-

**Kandidat mora da ispunjava sledeće uslove:**

- Da imaju odgovarajuće kvalifikacije visokog obrazovanja;
- da budu kvalifikovani i da imaju profesionalno iskustvo najmanje 10 godina u relevantnoj oblasti;
- da ima najmanje 5 godine radnog iskustva u obrazovanju, menadiranju ili slično;
- da ima završen trening za evaluaciju, razvoj kurikuluma, razvoj programa;
- da imaju znanje o informativnoj tehnologiji.

**Zadaci i odgovornosti:**

- Izabrani eksperti će potpisati poverljivi ugovor sa NAK,
- Razmatraju aplikacije i svu dokumentaciju ponuđača POO-a za akreditaciju institucija,
- Obavljaju posete na terenu,
- Sarađuju sa ostalim članovima panela, diskutuju i usklađuju njihove stavove,
- Doprinose u pripremi izveštaja koji sadrži nalaze i preporuke u vezi akreditaciju institucija,
- Izvestava direktora NAK-a.

Podstiču se svi zainteresovani koji ispunjavaju uslove, da dostave sledeća dokumenta:

- CV formata europass;
- Diplome i certifikati;
- Preporuke.

Dokumenta koji ne ispunjavaju gorenavedene uslove i kriterijume neće se razmatrati.
Prijavljivanje se vrši samo u elektronskoj formi na meil **donjeta.nimani@rks-gov.net.**
**Nacionalni autoritet za kvalifikacije,**
**Ul. Agim Ramadani b.b, Studentski centar, Priština.**
**Tel: 038- 212 595**
**Roka za prijavu: od dana 23.01.2019 do 01.02.2019.**
**Za više informacije kliknite na: www.akkks.rks-gov.net**

---

FSSHK

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
The Trade Union Health Federation of Kosova
Sindikalna Federacija Zdravtva Kosova

# ANULIM I FTESËS PËR OFERTË

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, anulon: Ftesën për ofertë për blerjen e një Veture për nevojat e zyrës Qendrore të FSSHK-së, te shpallur ne gazetën ditore Epoka e re me datë 10 janar 2019.

---

Shpallje për gazetë

Ofertë për shitjen e patundshmërisë

**1.** Erhan Mulla, me adrese ne rr."Remzi Ademaj" nr.34 KK Prizren, i pajisur me letërnjoftim – numër personal 1173606938 të lëshuar nga MPB e Kosovës – Prishtinë,
**2.** Edisa Mulla, me adrese ne rr."Remzi Ademaj" nr.34 KK Prizren, i pajisur me letërnjoftim – numër personal 1007151744 të lëshuar nga MPB e Kosovës – Prishtinë, dhe janë bashkëpronar me pjesën prej 3/2072 e pjesës ideale (15 m2) të patundshmërisë, me numër të Njësisë kadastrale P-71813068-06712-0, në vendin e quajtur "Pashaallti", me kulturë bujqësore arë e kl.3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5188 m2, Zona kadastrale Prizren,
Nga pjesa e vet ideale oferton për shitje sipërfaqen e pergjithshme prej 200 m2 të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 2.800 € (me shkronja: Pesëdhjet mijë euro).

Prizren, 23.01.2019

Ofertuesit,
1.Erhan Mulla
2.Edisa Mulla

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
*Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera/Office of Prime Minister*

Zyra për Çështje te Komuniteteve/Kancelarija za pitanja zajednica/Office for Community Affairs

# KONKURS

**Programi i praktikës në institucionet e nivelit qendror dhe lokal**

Zyra e Kryeministrit / Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZKM / ZÇK), në bashkëpunim me Ambasadën e Norvegjisë, shpall konkurs për "**Programin e praktikës në institucionet publike në nivel qendror dhe lokal**", për studentët e vitit të fundit të sudimeve themelore dhe master dhe për të diplomuarit e studimeve themelore dhe master nga radhët e komuniteteve jo shumicë (në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës), për të ndihmuar zhvillimin profesional të këtyre komuniteteve në Kosovë.

Zhvillimi profesional paraqet investim serioz dhe për këtë arsye, kjo fushë është përcaktuar si një qëllim i qartë që i referohet prioritetit përkatëse strategjik të ZÇK-së. Me këtë program, do t'iu mundësohet pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë për të fituar përvojë pune profesionale me qllim të lehtësimit të gjetjes së punës së qëndrueshme në të ardhmen. Gjithashtu, ZÇK dëshiron të nxisë rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve jo shumicë në institucionet publike.

**Shënim:** *Duke pasur parasysh se komunat, për shkak të madhësisë së tyre, nuk disponojnë me kapacitete të mjaftueshme për t iu mundësuar praktikantëve kushtet e nevojshme për punë, i lusim praktikantët potencial që të kenë mirëkuptim nëse ne nuk do të jemi në gjendje për t'i vendosur ata në afërsi të komunës nga e cila vijnë, dhe në atë rast do t'iu ofrohen institucionet e nivelit qendror.*

**Pas përfundimit të programit të stazhit, të gjithë praktikantët të cilët kanë përfunduar me sukses programin do të marrin një çertifikatë.**

**Procesi**
Pas përfundimit të konkursit, ZÇK-ja, do të formojë, në përputhje me ligjin dhe procedurat, një komision për zgjedhjen e kandidatëve. Do të përzgjidhen 100 kandidatë, për të kryer stazhin në institucionet publike në nivel lokal dhe qendror.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të ftohen për një test me shkrim. Kandidatët të cilët marrin numër të mjaftueshëm të pikave do të ftohen për intervistë.

Pas përzgjedhjes së knadidatëve për punë praktike, atyre do t'iu ofrohet kursi falas i gjuhës shqipe dhe serbe. Kursi është i dizajnuar të zgjasë tre muaj dhe pas përfundimit me sukses të kursit, kandidatët do të fillojnë me punë praktike. Gjatë kursit, kandidatët nuk do të marrin kompenzim në të holla.
**Aplikacionet e kandidatëve që kanë marrë pjesë në raundin e parë dhe të dytë të programit të praktikës, të vitit 2015-2016 dhe 2018 nuk do të merren parasysh**.

**Kriteret e përgjithshme për aplikim:**

- Të jenë shtetas të Kosovës;
- Të jenë studentë në vitin e fundit të studimeve themelore ose master, të diplomuarit e studimeve themelore dhe master;
- Të jenë jo më të vjetër se 30 vjeç;
- Të kenë njohuri të një gjuhë zyrtare të Kosovës.

1. **Dokumentacioni mbështetës për aplikimin;**
2. **Formulari i aplikimit duhet të plotësohet në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës (serbisht / shqip), në formë të përmbledhur me të dhëna të sakta (që do të merret në konsideratë vetëm formulari i ZÇK);**
3. **Një kopje të letërnjoftimit / pasaportës të vlefshme të Kosovës;**
4. **Dëshmi e stazhit studentor ose kopje të diplomës;**
5. **Dëshmi mbi vijimit të kurseve dhe trajnimeve (nëse ka);**
6. **Një rekomandim nga një person i cili ju njeh dhe me të cilin ju nuk jeni në lidhje familjare.**

**Fondi i programit**
- ZÇK-ja do të ndajë 90.000 euro nga fondi i alokuar nga Ambasada Norvegjeze, i cili synon të zhvillojë dhe mbështet komunitetet në fusha të ndryshme, duke përfshirë dhe punësimin. Ky konkurs do të përfshijë 100 praktikantë në të gjithë Kosovën dhe kompenzimi mujor për ta do të jetë 150 euro, bruto për person. Programi i praktikës do të zgjasë gjashtë (6) muaj.
- Fondi total për një praktikantë, për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh është 900 €.
- Përfituesit e fondeve, bazuar në fondin, duhet të kenë një llogari bankare të veçantë, para se ZÇK / ZKM të bënë transferin e fondeve. Pagesa do të bëhet në euro dhe transferimi bëhet vetëm përmes transaksioneve bankare.

Brenda 30 ditëve nga data e mbylljes së konkursit, ZÇK do të shqyrtojë aplikacionet e dorëzuara dhe do të njoftoj kandidatët që janë në listën e ngushtë, si dhe do t'i ftojë ata në një test me shkrim. Vetëm kandidatët që e kalojnë testin do të ftohen për intervistë.

Formularin e aplikimit mund ta gjeni në **http://www.zck-ks.net** ose **www.kryeministri-ks.net**

Afati i aplikimit fillon nga data e publikimit, **më 24.01.2019, dhe do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, deri më datë 08. 02.2019 në ora 16:00**.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e tyre (të paketuara në një zarf) **në rr. Nënë Tereza, Ndërtesa e Qeverisë, kati i gjashtë, zyra nr. 606, ose me email zck-kpz-grants@rks-gov.net**

*** Shënim: Kopjet e dokumenteve të kërkuara, nuk do të kthehen.**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
*Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera/Office of Prime Minister*

Zyra për Çështje te Komuniteteve/Kancelarija za pitanja zajednica/Office for Community Affairs

# KONKURS

**Program stažiranja u institucijama na centralnom i lokalnom nivou**

Kancelarija Premijera/Kancelarija za pitanja zajednica (KP/KPZ), u saradnji sa Norveškom Ambasadom, objavljuje konkurs za **"Program stažiranja u javnim institucijama na centralnom i lokalnom nivou"**, za studente završne godine osnovnih i master studija i diplomce osnovnih i master studija iz redova nevećinskih zajednica (u skladu sa važećim zakonima Kosova), sa ciljem da pomogne profersionalni razvoj tih zajednica na Kosovu.

Profesionalni razvoj predstavlja ozbiljnu investiciju i zato je ova oblast definisana kao jasan cilj koji se odnosi na relevantni strateški prioritet KPZ. Ovim programom pripadnicima nevećinskih zajednica će se omogućiti da steknu profesionalno radno iskustvo u cilju olakšanja pronalaženja održivog posla u budućnosti. Takođe, KPZ želi da utiče na povećanje zastupljenosti nevećinskih zajednica u javnim institucijama.

**Napomena:** *Imajući u vidu da opštine, zbog svoje veličine, ne raspolažu dovoljnim kapacitetima kako bi stažistima omogućili neophodne uslove za rad, molimo potencijalne stažiste da imaju razumevanja ukoliko ne budemo u mogućnosti da ih smestimo u blizini opštine iz koje dolaze, da će im u tom slučaju biti ponuđene institucije na centralnom nivou.*

**Po završetku programa stažiranja, svi stažisti koji su uspešno završili program će dobiti sertifikat.**

**Proces**
Nakon završenog konkursa, KPZ će u skladu sa zakonom i procedurama, formirati Komisiju za izbor kandidata. Biće odabrano 100 kandidata koji će obavljati praksu u javnim institucijama na lokalnom i centralnom nivou.

Samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa biće pozvani na pismeni test. Kandidati koji osvoje dovoljan broj poena, biće pozvani na intervju.

Nakon odabira knadidata za stažiranje istima će biti obezbeđen beplatan kurs albanskog odnosno srpskog jezika. Kurs je predviđen da traje tri meseca, i nakon uspešno završenog kursa kandidati će početi sa stažiranje. Tokom trajanja kursa kandidati neće primati novčanu nakadu.
**Prijave kandidata koji su učestvovali u prvom i drugom krugu programa stažiranja, 2015-2016 godine, i 2018 neće biti razmatrane.**

**Opsti kriterijumi za prijavljivanje**
- Da budu građani Kosova;
- Da budu studenti na završnoj godini osnovnih ili master studija, diplomci osnovnih ili master studija;
- Da nisu stariji od 30 godina;
- Da poznaju jedan službeni jezik Kosova;

**Prateća dokumentacija za prijavu**
1. **Obrazac prijave mora biti popunjen na jednom od službenih jezika Kosova (srpski/albanski), u sažetom obliku i sa tačnim podacima (biće uzet u razmatranje samo obrazac KPZ);**
2. **Kopiju validne lične karte/pasoša Kosova;**
3. **Dokaz o studentskom stažu ili kopija diplome;**
4. **Dokazi o pohađanju kurseva i treninga (ako ih ima);**
5. **Jedna preporuka od osobe koja vas poznaje a sa kojom niste u srodstvu**

**Fond programa**
- KPZ će odvojiti 90000 evra iz fonda dodeljenog od strane Norveske Ambasade koji je namenjen razvoju i podršci zajednicama u raznim poljima, medju kojima spada i zapošljavanje. Ovim konkursom biće obuhvaćeno 100 stažista širom Kosova, a mesečne nadoknade će iznostiti 150 eura bruto po osobi. Program stažiranja će trajati šest (6) meseci.
- Ukupan fond po stažisti, za period od šest (6) memeci je 900€.
- Primaoci sredstava, na osnovu fonda moraju da poseduju poseban račun u banci pre nego što im KPZ/KP izvrši prenos sredstava. Isplata će se vršiti u evrima a prenos se vrši isključivo putem bankarske transakcije.

U roku od 30 dana od dana zatvaranja konkursa, KPZ će razmotriti podnete aplikacije i obavestiti kandidate koji su ušli u uži krug i pozvati ih na pismeni test. Samo kandidati koji polože test biće pozvani na intervju.

Aplikacioni obrazac se može naći na: **http://www.zck-ks.net** ili **www.kryeministri-ks.net**

Rok za apliciranje počinje od datuma objavljivanja, **24.01.2019. godine i trajće 15 (petnaest) dana, do 08.02.2019. godine u 16 00 časova.**

Zainteresovani kandidati treba da dostave svoja dokumenta (upakovana u kovertu) **u ul. Majke Tereze, Zgrada Vlade Kosova, šesti sprat, kancelarija br. 606, ili na email adresu zck-kpz-grants@rks-gov.net**

***Napomena: Dostaviti kopije traženih dokumenata jer dokumenta neće biti vraćena.**








# *BeyAb* for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.
















## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ D.P.Z "Alumini" shpall të pavlefshëm numrin e biznesit: 80075987 në Vushtrri.

▶ Bedrije Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Haxhi Ymer Lutfi" Mamushë.

▶ Nuhi Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi " Prizren.

▶ Avni Duraku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

▶ Ahmet Ahmeti shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Dursim Shala shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi " Prizren.

▶ Unë Fahri Avdiu distancohem nga djali im Bledi Fahri Avdiu dhe nuk marr asnjë përgjegjësi dhe asnjë obligim për veprat e tija, si borgje, vjedhje apo marrje të parasë me fajde. Si dhe njëkohësisht kërkoj nga ju të dëmtuarit që mos të më kontaktoni as në telefonin tim. Me respekt Fahri Avdiu.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA